

ANALIZË E SHKURTËR
Planifikim urban për qytetarët 5
Autore: Rozafa Basha
nëntor 2016, Prizren

PËRMBAJTJA

I.	Përmbledhja.....	2
II.	Hyrje.....	2
III.	Projekti “Qyteti Gjithëpërfshirës - lagje aktive për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”	3
IV.	Metodologjia e hulumtimit.....	3
V.	Rezultatet e hulumtimit	4
VI.	Përmbledhja e problemeve të evidentuara gjatë hulumtimit në qytet dhe fshat	26
VII.	Konkludim.....	35
	EC Ma Ndryshe.....	37

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, i përkrahur financiarisht nga Olof Palme International Center.



OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-777

I. Përmbledhje

Kjo analizë e shkurtër mëton t'i paraqesë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Prizrenit në lidhje me çështjet e planifikimit urban dhe menaxhimit të qytetit në përgjithësi. Analiza e prezantuar këtu është e pesta me radhë që realizohet brenda një periudhe katër (4) vjeçare në kuadër të projektit "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren". Ky projekt është financuar nga Olof Plame International Centre dhe ka për qëllim që t'i artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i zbatojë ato në plane urbane të komunës së Prizrenit. Gjatë këtyre katër viteve, në hulumtim janë përfshirë 1701 respondentë, duke pasur parasysh këtu edhe anketimin e fundit, në bazë të cilit po ndërtohet kjo analizë, dhe i cili përfshin anketimin e 327 të intervistuarve të grupmoshave të ndryshme nga 28 lagje në qytetin e Prizrenit, si dhe 75 intervista në tri fshatra.

Kjo analizë, përpos identifikimit të problemeve urbane në Prizren, me të cilat qytetarët përballen përditë, mëton të identifikojë edhe nevojat e tyre për një jetë më cilësore në qytet. Këto nevoja ndërlidhen ngushtë me të jetuarit e qëndrueshëm në qytet. Qëndrueshmëria urbane është një paradigmë aktuale, e cila përpos komponentës ekologjike, ekonomike, kulturore e ka edhe atë të mirëqenies sociale. Mirëqenia sociale mes tjerash përfshin rritjen e demokracisë lokale, gjegjësisht rritjen e praktikave të përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për qytet. Këto të fundit, krahas adresimit të nevojave reale të qytetarëve, ndihmojnë në ndërtimin e një qytetarie aktive ndër

komunitetet e lagjeve dhe qytetit në përgjithësi. Qytetaria aktive, në anën tjetër, përmes fuqizimit politik, ua mundëson qytetarëve t'iu ngrenë dhe drejtojnë pyetje politike dhe teknike autoriteteve që kanë të bëjnë me planifikimin dhe menaxhimin e qytetit. Përmes kësaj, qytetarëve iu bëhet e mundshme t'i njohin edhe mjetet themelore të veprimit politik, siç janë hulumtimi, komunikimi, avokimi dhe mendimi strategjik.

Dhe të gjitha këto me një qëllim të përbashkët: të arritjes së një mirëqenie më të madhe për të gjithë¹.

II. Hyrje

Pjesëmarrja qytetare në planifikim urban është paradigmë e planifikimit urban, që vë në pah përfshirjen e komunitetit në proceset strategjike dhe menaxheriale të qytetit, si dhe në proceset e planifikimit urban, dhe të komunitetit në përgjithësi. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e planifikimit urban, në Kosovë, edhe pse rregullohet me dispozita ligjore në fuqi, kufizohet kryesisht në komentimin e planeve hapësinore që shpalosen për një periudhë kohore, para miratimit zyrtar.

Nevoja për përfshirjen e një publiku më të gjerë në procesin e planifikimit urban siguron që ato plane të jenë relevante dhe të zbatueshme si dhe që hapësira urbane apo vendbanimet e prejardhura prej një procesi të tillë t'iu shërbejnë banorëve të vet gjatë gjithë jetës.

Nëse caku i secilës qeveri lokale është zhvillimi dhe prosperimi i qytetit dhe rritja e atraktivitetit të tij për të gjithë qytetarët, proceset e qeverisjes duhet të ndryshojnë për t'u arritur këto caqe. Për këtë duhet të arrihet një konsensus, të zhvillohen proceset e konsultimeve publike, dhe reforma

¹Basha, R., Planifikimi urban për qytetarët 2, EC Ma Ndryshe, dhjetor 2013

institucionale, me qëllim të fundmë ngritjen e qytetarisë dhe zgjerimin e gjithëpërfshirjes qytetare.

III. Projekti “Qyteti Gjithëpërfshirës - lagje aktive për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”

Projekti synon të sjellë komunitetin në thelbin e proceseve të planifikimit urban në komunën e Prizrenit. Përmes aktivizmit me bazë komuniteti (mobilizim të komunitetit në nivel lagjeje) projekti është një përpjekje për të përmirësuar planifikimin urban në një nivel gjithëpërfshirës, duke e shndërruar atë nga një aktivitet teknik në një aktivitet më njerëzor. Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të inkurajojë pjesëmarrjen e grupeve të komunitetit (grupet e nën-përfaqësuar në nivel lagjeje) në proceset e planifikimit urban në Prizren. Projekti do të ketë tre objektiva të ndërmjetëm: 1. Të identifikojë dhe të përkthejë nevojat dhe interesat e komunitetit në plane, politika, projekte dhe vendime relevante dhe të zbatueshme të pushtetit lokal, 2. Të krijojë dhe fuqizojë grupet e veprimit të komunitetit në çdo lagje urbane të Prizrenit, dhe 3. Të sponsorizojë miratimin dhe mbikëqyrë zbatimin e Rregullores për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Urban.

Grupet kryesore të synuara të projektit janë: grupet e komunitetit në nivel lagje, grupe të nën-përfaqësuar të komunitetit të bazuara në identitet, grupet e organizuara qytetare, organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e komunitetit, profesionistët e planifikimit urban dhe autoritetet publike në nivel lokal. Një numër i palëve të interesit do të jenë të angazhuar në aktivitetet e projektit: organizatat e shoqërisë civile të Prizrenit, autoritetet publike të nivelit qendror, ofruesit e shërbimeve publike, institucionet e zbatimit të ligjit, institucionet e arsimit të lartë, media lokale dhe kombëtare, dhe organizatat ndërkombëtare.

Aktivitetet e projektit përfshijnë: takime të lagjes, punëtori të vizionimit, shfaqje publike (aktivizmi kulturor), anketa të qytetarëve dhe rekomandimet e politikave, aktivizëm ndaj

autoriteteve, përmirësim të platformës online mahalla.info, dialog të strukturuar me autoritetet publike, monitorim të qeverisjes lokale (në veçanti zbatimin e Rregullores për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Urban).

IV. Struktura dhe metodologjia e hulumtimit

1. Hulumtimi në lagjet e qytetit

Pjesa kuantitative e hulumtimit është realizuar përmes pyetësorëve të realizuar në formë intervistash, duke përfshirë 327 pjesëmarrës nga nëntë lagje së bashku me qendrën e qytetit. Pjesëmarrësit kanë pasur moshë dhe përkatësi të ndryshme etnike.

Të dhënat në terren janë mbledhur në disa lagje të ndryshme të qytetit me të cilat ka bashkëpunuar edhe më herët organizata EC Ma Ndryshe:

- Qendra
- Lagjja Bajram Curri
- Lagjja e transitit – Arbana
- Lagjja Tabakhane
- Lagjja Bazhdarhanë
- Lagjja Dardania
- Lagjja Nënkalaja
- Lagjja Qyk Mahalla
- Lagjja Ortakoll
- Lagjja Tusuzi

Numri i anketave që janë plotësuar nga anketuesit është i ndarë nëpër lagje, në lokacione të caktuara përbrenda çdo lagjeje dhe në qendër të Prizrenit.

Tabela 1.1: Ndarja e të anketave sipas lagjeve

Nr.	Lagjja	Nr. i të anketuarve
1	Jeta e Re	7
2	Lagjja e Romëve	15

3	Lagjja Arbana	21
4	Lagjja Tabakhane	13
5	Lagjja Bazhdarhane	15
6	Lagjja Papasqarshia	10
7	Lagjja Nën kalaja	7
8	Lagjja e Qylhanit	7
9	Lagjja Ortakoll	38
10	Lagjja Tusuzi	28
11	Terzimahalla	20
12	Kurila	22
13	Hoqamahalla	20
14	Adnan Krasniqi	2
15	Aleksander Flimingu	1
16	Banesat TEB Banka	8
17	Banesat te Abi	8
18	Lakuriqi	13
19	Ismet Jashari	2
20	Lagjja te Xhamia	1
21	Leke Dukagjini	1
22	Petrova	14
23	Red Bull	21
24	Xhamia Emin Pasha	7
25	Mustafa Bakiu	2
26	Ralin	9
27	Xhamia e Mazllumit	7

28	Xhuma Xhamia	8
Totali:		327

2. Hulumtimi në fshatra

Pjesa kuantitative e hulumtimit është realizuar përmes pyetësorëve të realizuar në formë intervistash, duke përfshirë 75 pjesëmarrës nga tre fshatra të Komunës së Prizrenit. Pjesëmarrësit kanë pasur mosha të ndryshme dhe etni shqiptare apo boshnjake.

Të dhënat janë mbledhur në këto fshatra dhe me këta numra:

Tabela 1.2: Ndarja e të anketave sipas fshatrave

Nr.	Fshati	Nr. i të anketuarve
1	Gjonaj	18
2	Reqan	22
3	Zhur	35
Totali:		75

V. Rezultatet

1. Rezultatet e hulumtimit në lagjet e qytetit


Rezultatet që prezantohen në këtë raport pasqyrojnë mendimet e qytetarëve të Prizrenit siç i kanë shprehur në pyetësorin e përgatitur nga EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me ARS. Mostra përbëhet nga 327 të anketuar që janë intervistuar në lokacione të ndryshme brenda nëntë lagjeve dhe në qendër të qytetit të Prizrenit. Këto rezultate do të plotësohen nga rezultatet e 4 hulumtimeve të mëparshme që janë kryer gjatë katër viteve të fundit në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi urban për qytetarët”. Hulumtimi i parë është

kryer në prill të vitit 2013 dhe ka përfshirë 249 të anketuar. Hulumtimi i dytë është realizuar në shtator të vitit 2013 dhe ka anketuar 250 pjesëmarrës. Në hulumtimin e tretë, i cili është kryer në qershor të vitit 2014 kanë marrë pjesë 400 të anketuar. Ndërkaq, hulumtimi i fundit është realizuar në dhjetor të vitit 2015 dhe ka mbledhur mendimet e 499 qytetarëve.

Informatat demografike


Përbërja e mostrës së hulumtimit përfshiu 57% (187) të pjesëmarrësve të gjinisë femërore dhe 43% (142) të pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore.

Fig. 1.1: Gjinia



Për t'i bërë rezultatet më të lexueshme, mosha e të anketuarve është e ndarë në 3 grupe. Prej këtyre, 17% (56) i përkasin grupmoshës prej 16-25 vjeç; 71% (233) i përkasin grupmoshës prej 26-64 vjeç, dhe grupi i fundit përbëhet nga personat mbi 65 vjeç, të përfaqësuar në këtë anketë me 12% (38).


Fig. 1.2: Grupmoshat e participantëve



Arsimimi

Në masë të madhe, të anketuarit mund të konsiderohet se kishin përcjellë apo mbaruar shkollën e mesme me 9 deri në 13 vite shkollimi, duke përfshirë rreth **43%** të popullatës. Ndërkaq, 28% (91) prej tyre kanë përfunduar 14 deri në 18 vite shkollimi. 27% kanë vijuar shkollën fillore dhe vetëm 1.5% (5) prej të anketuarve nuk kanë raportuar të kenë arsim formal.


Fig. 1.3: Niveli i arsimimit të participantëve



Të ardhurat mujore

Sa i përket të ardhurave mujore, të anketuarit janë pyetur se sa të ardhura kanë pasur mesatarisht gjatë tre muajve të fundit. Duke i ndarë përgjigjet në grupe sipas normës tatimore të vendosur nga Administrata Tatimore e Kosovës, 42% (138) raportuan se kishin të ardhura nga 0 deri në 80 euro në muaj, 10% (32) kishin të ardhura nga 80 deri në 250 euro, 14% (45) raportonin se fitonin nga 250 deri në 450 euro, kurse 34% (112) e popullatës fitonte më shumë se kaq.

Fig. 1.4: Të ardhurat mujore të të anketuarve



Rezultatet nga pyetjet profesionale të nxjerra nga pyetësi

Sipas rezultateve të nxjerra nga hulumtimi shihet se 48% (156) të të anketuarve nuk kanë njohuri/informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plan urban, ndërsa 52% (171) prej tyre kanë njohuri për këtë.

Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë (prill 2013) 62.7% e të anketuarve kanë deklaruar të kenë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Në hulumtimin e dytë (shtator 2013) 64.3% kanë raportuar të kenë njohuri se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Ndërsa, në hulumtimin e 3 (tetor 2014) 50.3% e të anketuarve kanë deklaruar të kenë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Ndërkaq, në hulumtimin e fundit (dhjetor 2015) 42% kanë raportuar të kenë njohuri se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Nga 52% të cilët kanë informata rreth planit urban të komunës së Prizrenit, prej tyre 67% (104) këtë informatë e kanë marrë nga mediat (TV apo shtypi), ndërsa 24% (38) prej tyre informatën e kanë marrë nga të afërmit. Pjesa e mbetur janë informuar me mjete të tjera, sikurse organizatat joqeveritare, debatet apo portalet.

Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë nga 155 (62.2%) të anketuar që kanë deklaruar se kanë njohuri për atë se Prizreni ka plan urban 69% kanë dëgjuar për planin urban nga mediet, 18.7% nga të afërmit dhe 12.3% nga të tjerët.


Në hulumtimin e dytë nga 157 (67.9%) të anketuar kanë deklaruar se informatën për

ekzistimin e planit urban të Prizrenit e kanë marrë nga mediet 77.1%, nga të afërmit 12.1 dhe të tjerët 10.8%.

Ndërsa në hulumtimin e tretë nga 151 (50.3%) të anketuar kanë deklaruar se kanë njohuri se Prizreni ka plan urbanistik, 35.0% e tyre kanë dëgjuar nga mediet, 10.3% nga të afërmit si dhe 4.0% nga të tjerët.


Ndërkaq, në hulumtimin e katërt prej 42% sa kanë deklaruar se janë të informuar se Prizreni ka plan urbanistik, 70% (147) këtë informatë e kanë marrë nga mediet (TV apo shtypi), ndërsa 18% prej tyre informatën e kanë marrë nga të afërmit.

Fig. 1.5: Nga e keni marrë këtë informatë?




Në pyetjen se a janë të informuar qytetarët e Prizrenit se qyteti i tyre ka një plan komunal, 35% (113) janë përgjigjur pozitivisht, 10% (34) janë përgjigjur negativisht, ndërsa 50% (163) janë përgjigjur se nuk kanë informatë. Qytetarët janë përgjigjur ngjashëm edhe në pyetjen nëse qyteti ka plan zhvillimor urban, ku 26% (85) janë përgjigjur pozitivisht, 7% (24) janë përgjigjur negativisht, ndërsa 61% (201) janë përgjigjur se nuk kanë informatë.

Fig. 1.6: A keni njohuri/informatë nëse Prizreni ka Plan Zhvillimor Komunal/Urban?



Vlera të ngjashme janë edhe me pyetjen se sa janë qytetarët e informuar se ka qyteti i tyre plane të ndryshme për zhvillimin e lagjeve. Rezultatet tregojnë që 30% (96) e të anketuarve e kanë këtë informatë, 22% (74) prej tyre përgjigjen negativisht, ndërsa 43% (143) të anketuarve nuk kanë pasur informata për këtë.

Fig. 1.7 A keni njohuri/informatë nëse qyteti i Prizrenit ka Plane Rregulluese për lagjet?



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë meshkujt kanë raportuar se me përqindje më të lartë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin me 50.5% ndërsa vetëm 1/3 e femrave kanë raportuar se kanë informatë për këtë çështje.

Në hulumtimin e dytë, siç mund të shihet edhe nga figura e mësipërme, ka një rritje të ndjeshme të femrave që kanë raportuar se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e


planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin më saktësisht 69.6% dhe meshkujt me 69.3%.

Në hulumtimin e tretë meshkujt kanë raportuar në përqindje më të lartë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në përqindje prej 39.3%, ndërsa nga ana tjetër 31.7% e femrave kanë raportuar se kanë informatë në lidhje me këtë çështje.

Në hulumtimin e katërt, 33% nga të gjithë të anketuarit kishin deklaruar se e dinin që mund të marrin pjesë në procesin e planifikimit urban, ndërsa vetëm 30% e dinë se mund të kontribuojnë në planet e ndryshme për lagjet e tyre.

Kur bëhet fjalë se a kanë janë ftuar qytetarët personalisht apo përmes ftesave publike për të marrë pjesë në zhvillimin e ndonjë plani urban të qytetit, vetëm 10% (34) prej tyre janë përgjigjur me PO, ndërsa 90% (327) me JO.

Fig. 1.8: A jeni ftuar ose për të marrë pjesë në zhvillimin e ndonjë plani urban të qytetit?



Kur qytetarët janë pyetur se a u janë përgjigjur këtyre ftesave duke marrë pjesë në aktivitete, 13 prej tyre raportuan se kanë vijuar debatet publike, 4 kishin shkuar në takimet nëpër lagje, kurse vetëm 2 kishin qenë pjesë e grupeve punuese për hartimin e planeve.

Krahasimi me anketimet e mëparshme

Në hulumtimin e parë nga përqindja e qytetarëve që kanë deklaruar se janë në dijeni se komuna organizon debate publike vetëm 7.6 të tyre kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në ndonjërin prej tyre.

Në hulumtimin e dytë nga përqindja e qytetarëve që kanë thënë se kanë njohuri se komuna organizon debate publike vetëm 12.6% kanë thënë se kanë marrë pjesë në ndonjërin prej tyre. Nga debatet janë përmendur këto: në kuvend komunal; në lagje, në shtëpi të kulturës, me organizatën Ec ma Ndryshe, për qendrën e qytetit në shtëpi të kulturës, për rregullimin e një banese dhe një për qendrën sportive.


Në hulumtimin e tretë, nga përqindja e përgjithshme prej personave që kanë njohuri për organizimin e debateve publike, vetëm 1.3% kanë deklaruar që kanë marrë pjesë, 38.3% kanë raportuar që nuk kanë marrë pjesë si dhe 60.3% kanë qenë pa përgjigje (në këtë përqindje përfshihen edhe ata që kanë thënë se nuk kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin).

Në hulumtimin e katërt, vetëm 20% (90) e qytetarëve kanë ditur se komuna organizon debate publike në lagje. Prej këtyre, 94% nuk kanë marrë pjesë në debate publike. Kur bëhet fjalë nëse qytetarët kanë njohuri për planet rregulluese në lagjet e tyre dhe se a kanë qenë ndonjëherë të ftuar, 92% e tyre janë përgjigjur negativisht dhe vetëm 8% e tyre kanë qenë pjesë e planeve rregulluese.

Sa i përket pjesëmarrës së qytetarëve në debate publike të cilët kanë qenë të ftuar nga organet komunale personalisht apo përmes një ftese të përgjithshme, 92% (302) prej tyre nuk kanë qenë të ftuar në debate publike dhe 8% (25) kanë qenë të ftuara në këto debate. Saktësisht e njëjta përqindje e qytetarëve ka raportuar për ftesën

apo mungesën e ftesës në debate qytetare nga organizatat e ndryshme joqeveritare. Nga të anketuarit e ftuar, 8 kishin marrë pjesë në debate publike, 5 kishin vijuar takimet në lagje, 2 qytetarë kishin qenë pjesë e grupeve punuese për hartimin e planeve, kurse vetëm një qytetar kishte vijuar një punëtori.

Fig. 1.9: A jeni ftuar nga organet komunale/organizatat joqeveritare në ndonjë debat me një çështje tjetër të caktuar?



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë vetëm 15.7% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë ftesë nga organet komunale për debate publike për çështje të ndryshme të qytetit. Rezultate të ngjashme janë gjetur edhe në hulumtimin e dytë ku 14.7% e qytetarëve kanë deklaruar se janë ftuar në debate publike të organizuar nga komuna.

Nga 15.7% të qytetarëve që kanë marrë ftesë për debate nga komuna në hulumtimin e parë vetëm 1/4 e tyre kanë marrë pjesë në takimet në të cilat janë ftuar. Nga 10 qytetarë që kanë marrë pjesë në takime i kanë cekur këto takime: për arsim, për komunitetin RAE, për menaxhim të mbeturinave, për rregullimin e pronave, për rregullimin e lagjes, për rrugën e farkëtarëve, për të drejtat e grave dhe dhunën në familje.

Në hulumtimin e parë 13.7 % të qytetarëve kanë deklaruar se janë ftuar nga OJQ, apo shoqëria civile për ndonjë debat të caktuar. Nga ata që kanë marrë ftesë për debat publik nga OJQ 41.2%

kanë theksuar se kanë marrë pjesë në takimet që janë ftuar nga shoqëria civile apo OJQ-të dhe 58.8% kanë thënë se nuk kanë marrë pjesë. Nga ata që kanë cukur llojin e takimit vetëm katër kanë qenë të ndërlidhur me planin urban apo me planifikimin urban.

Në hulumtimin e dytë nga 14.7% të qytetarëve që kanë deklaruar se kanë marrë ftesë për të marrë pjesë në debate publike vetëm 14% të tyre u janë përgjigjur ftesave dhe 86% të ftuarve nuk kanë marrë pjesë në hulumtime.

Në hulumtimin e dytë vetëm 8.2% të popullatës kanë deklaruar se kanë qenë të ftuar në ndonjë debat publik nga shoqëria civile/OJQ në lidhje me çështje të caktuar. Nga 21 apo 8.2% të të anketuarve që kanë marrë ftesë vetëm 6 prej tyre apo 28.6% që kanë marrë ftesë u janë përgjigjur këtyre ftesave me pjesëmarrje. Për temat e shqyrtuara në takim janë përmendur këto: në kryq të kuq për çështje humanitare, nga enti për punësim, nga KDI, nga Save the Children dhe në lidhje me urbanizëm.

Në hulumtimin e tretë, në pyetjen se a kanë qenë të ftuar në ndonjë debat publik, 11.0% e popullatës kanë marrë ftesë nga organet komunale, për dallim nga 87.3% e tyre që nuk kanë qenë të ftuar. Nga ata që kanë marrë ftesë vetëm 5.0% e tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë ftuar. Nga popullata e përgjithshme, personat të cilët kanë marrë pjesë nëpër debate publike kanë biseduar për çështjet të ndryshme siç janë: ambienti, hartimi i planit të ri urbanistik, kanalizimi dhe asfaltimi i lagjes, projektet e Kryqit të kuq për Prizren, për banesat e lagjes si dhe për rregullimin e planit hapësinor.

Në hulumtimin e tretë, të anketuarit kanë deklaruar me një përqindje prej 19.30 % që janë ftuar për të marrë pjesë në debate të organizuara nga OJQ apo shoqëria civile për ndonjë debat të caktuar. Nga ata që kanë marrë ftesa 10.7% e


tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë thirrur. Nga organizatat që kanë marrë pjesë në debate publike, çështjet të cilat janë diskutuar janë si: infrastruktura, buxheti për persona me aftësi të kufizuara, për planet e veprimit për romët, për planifikim të buxhetit, kornizat afatmesme të buxhetit, për arsim/edukim, për ndriçimin publik, për planifikimin urbanistik, për raste sociale, për rregullimin e qytetit, për varrezat - kompleksi Landovicë, rregullimi i shkallëve në Kala, rregullimi i ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit, rregullorja për vullnetarizëm, për sportin, për të drejtat e grave dhe barazi gjinore, si dhe për trashëgiminë kulturore.

Në hulumtimin e katërt, 82% (410) e të anketuarve nuk kanë qenë të ftuar nga organet komunale në ndonjë debat publik apo aktivitet, kurse 18% prej tyre kanë qenë të ftuar në këto debate. Nga kjo shifër, të anketuarit kanë deklaruar se 47% kanë marrë pjesë në debat dhe 53% nuk kanë marrë pjesë në debat edhe pse kanë qenë të ftuar.

Në hulumtimin e katërt, 86% e qytetarëve janë përgjigjur negativisht që janë ftuar në ndonjë lloj debati apo aktiviteti nga organizatat e ndryshme, dhe 14% e tyre kanë deklaruar se janë ftuar në debate publike nga organizatat. Nga ky grup, 48% (33) e tyre kanë marrë pjesë në debat dhe 52% nuk kanë marrë pjesë në debat publik.

Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve në iniciimin e nismave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në lagjet e tyre, të anketuarit kanë deklaruar se 15% (49) kanë qenë pjesë e iniciativave për të bërë ndryshime në lagjet e tyre, ndërsa 85% (278) nuk e kanë bërë këtë gjatë viteve të fundit.

Fig. 1.10: A keni provuar personalisht apo në grup me qytetarët tjerë që të ndërmerrni ndonjë nismë për zgjidhjen e ndonjë problemi në lagjen/fshatin tuaj gjatë viteve të fundit?



Prej këtyre qytetarëve, 249 persona i janë përgjigjur pyetjes “Si i keni artikuluar nevojat tuaja në raport me organet komunale?” 41 qytetarë janë deklaruar se kanë nënshkruar petition drejtuar organeve komunale, 33 kanë shprehur shqetësimet e tyre në takime të drejtpërdrejta me zyrtarët komunalë, 29 prej tyre i kanë shprehur opinionet e tyre në diskutime publike, kurse pjesa tjetër nuk kanë shkuar më tej në shprehjen e shqetësimeve të tyre.

Qytetarët kanë treguar edhe çfarë ka ndodhur me shqetësimet e tyre. 71% (231) prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pas ndonjë reagim nga komuna, 11% (37) u është premtuar se do të zgjidhet problemi por nuk ka pasur rezultate, 11% (35) shprehen se problemi është zgjidhur pjesërisht, kurse vetëm 7% (24) deklarohen se problemi është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme.

Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë, shumica e të anketuarve apo 61% kanë thënë se personalisht kontaktojnë me organet komunale, 30% të respondentëve kanë deklaruar se nuk e dinë se si mund t'i artikulojnë nevojat e tyre dhe vetëm 6% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme. Ndërsa forma të tjera të komunikimit me 3.6% kanë qenë përmes

familjarëve, 4 kanë thënë se nuk komunikojnë fare për shkak të mungesës së besimit, organet gjyqësore, përmes kryetarit të lagjes, dhe petitionin.


Në hulumtimin e dytë ka një rritje të përqindjes së qytetarëve që deklarojnë se vetë i artikulojnë nevojat e tyre në komunë 72.3% dhe ka një rënie të përqindjes së qytetarëve që deklarojnë se nuk dinë si t'i artikulojnë nevojat e tyre nga 30% në hulumtimin e parë në 21.3% në hulumtimin e dytë dhe 4.4% kanë raportuar se e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme.

Në hulumtimin e tretë pjesa më e madhe e të anketuarve apo 61.7% kanë thënë se personalisht kontaktojnë me organet komunale, 7.7% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme, 4.7% e tyre nuk e din se si t'i artikulojnë nevojat që i kanë, si dhe 4.0% e tyre kanë forma të tjera të komunikimit me organet komunale.

Në hulumtimin e katërt, 57% e qytetarëve raportuan se i kontaktonin vetë organet komunale, 13% prej tyre treguan se i kontaktonin përmes organizatave të ndryshme, dhe 8% nuk kishin ndonjë ide se si t'i artikulonin nevojat e tyre në raport me organet komunale.


Kur qytetarët janë pyetur nëse kanë pas ndonjë mundësi që problemet e tyre t'i artikulojnë dhe paraqesin para kryetarit të komunës, 94 % (309) e tyre kurrë nuk kanë pasur rastin t'i paraqesin problemet e tyre para kryetarit ndërsa vetëm 6% (18) prej tyre janë deklaruar pozitivisht. Në pyetjen e njëjtë por për drejtorët e qeverisë komunale në vend të kryetarit të komunës, 92% (301) e qytetarëve janë deklaruar se nuk e kanë pasur rastin t'i shprehin shqetësimet e tyre, kurse vetëm 8% (26) kanë mundur t'ua kumtojnë drejtorëve të qeverisë komunale brengat e tyre.

Fig. 1.11: A keni pasur ndonjë mundësi që problemet e lagjes/ fshatit t'i paraqitni para kryetarit të komunës/drejtorëve të qeverisë komunale?



Sa i përket organizimeve/organizatave në lagje, 91% (297) e qytetarëve janë përgjigjur se nuk ekziston një formë e organizimit të qytetarëve të një lagjeje dhe 9% (30) prej tyre kanë thënë se ekziston një organizim i tillë. Ndërkaq, rreth 11% (37) e të anketuarve janë deklaruar se në lagjen/fshatin e tyre ekziston një këshill lokal, kurse 89% (290) prej tyre janë deklaruar negativisht.


Fig. 1.12: Në lagje, a ekziston ndonjë grup i organizuar/organizatë/këshill lokal që merret me adresimin e problemeve të lagjes/fshatit?



Ndërsa kur qytetarët janë pyetur nëse komuna inkurajon funksionimin e këshillave lokale në lagje, 63% (397) e tyre kanë deklaruar se komuna nuk i inkurajon këto organizime ose nuk janë në dijeni për një gjë të tillë, ndërsa vetëm 37% (95) e tyre kanë thënë që po.

Sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike në lagje qytetarët kanë deklaruar se në 44% (144) të rasteve ata i shfrytëzojnë ato disa herë gjatë muajit, 31% (102) disa herë gjatë javës, 16% (51) e bëjnë këtë për çdo ditë, kurse vetëm 9% (30) nuk i shfrytëzojnë hapësirat publike.


Fig. 1.13: A i frekuentoni hapësirat publike në qytet, nëse po, sa shpesh?



Përqindja e qytetarëve të cilët janë aktivë, të angazhuar në organizata të ndryshme është mesatarisht 3%. Mesatarisht 5% prej tyre kanë deklaruar se janë anëtarë joaktivë apo kanë qenë të anëtarësuar më parë, kurse 91% kanë deklaruar se nuk i takojnë asnjë organizate.

Prej këtyre, më së shumti anëtarë aktivë kanë sindikatat e punës me 5% (19), organizatat humanitare ose bamirëse me 4% (13), si dhe organizatat rinore me 3% (11).

Fig. 1.14: Përqindja mesatare e qytetarëve që janë pjesë në organizata të ndryshme



Krahasimi me anketimet e mëparshme

Nga hulumtimi i parë del se:

- 4.8% e qytetarëve aktivë janë në parti politike,
- 4.4% në organizata e artit, kulturës dhe arsimit dhe
- 4.3% në organizata fetare.

Në hulumtimin e dytë, përqindja më e madhe e qytetarëve aktivë në organizata kanë rezultuar të jenë:

- sindikatat me 6.4% anëtarë aktivë,
- organizatat sportive - rekreative me 5.6% anëtarë aktivë
- parti politike me 3.2% si anëtarë aktiv.

Në hulumtimin e tretë përqindja më e madhe e qytetarëve aktiv në organizata ka rezultuar të jetë kështu:

- parti politike me 10%,
- organizatat sportive dhe rekreative me 8.0%
- organizatat e artit, kulturës dhe arsimit me 7.0%,
- 6.7% organizata fetare.


Në hulumtimin e katërt, përqindja e qytetarëve të ishin aktivë, të angazhuar në organizata të ndryshme ishte 4%, ndërsa 6% e tyre kishin deklaruar se kanë qenë të angazhuar në organizata mirëpo më nuk vazhdonin të jenë, dhe 90% kanë deklaruar se nuk i takonin asnjë organizate.

Kur qytetarët janë pyetur se a kanë nënshkruar ndonjëherë petition, 37% (121) prej tyre kanë deklaruar se kanë nënshkruar, 53% (172) kanë thënë se ndoshta do ta bënin, ndërsa 10% (34) prej tyre kanë deklaruar se nuk do ta bënin fare.

Sa i përket bashkëngjitjes në bojkot, 9% (29) kanë deklaruar se e kanë bërë, 68% (223) se ndoshta do ta bënin, dhe 23% (75) që nuk do ta bënin asnjëherë. Gjithashtu, edhe në pyetjen për pjesëmarrje në greva të punëtorëve, rezultatet

janë respektivisht 9%, 70%, dhe 21%, kurse për pyetjen rreth pjesëmarrjes në demonstrata paqësore, rezultatet janë respektivisht 32%, 52%, dhe 16%.

Fig. 1.15: Pjesëmarrje e qytetarëve në nënshkrimin e peticioneve, bashkëngjitjes në bojkot, pjesëmarrjes në greva të punëtorëve, dhe pjesëmarrjes në demonstrata paqësore



Pyetje për të gjithë të intervistuarit

Pjesë e hulumtimit kanë qenë edhe disa pyetje gjithëpërfshirëse, objektive të cilave kanë qenë disa nga çështjet urbanistike të komunës së Prizrenit. Në këtë pjesë, qytetarëve u është kërkuar të zgjedhin 5 nga problemet më të rëndësishme, të cilat duhet të adresohen nga organet komunale.

Fig. 1.16: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale



Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga qytetarët janë:

1. Bllokimi i trotuareve - 21%
2. Problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara – 16%
3. Shkatërrimi i qendrës historike – 15%
4. Mungesa e korsive për biçikleta – 16%
5. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet – 15%

Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë qytetarëve ju janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit dhe ju është kërkuar që ata ti zgjedhin 4 çështje që duhet të kenë një adresim më serioz nga organet komunale. Analiza është bërë për të gjitha opsionet nëse është përmendur si çështje nga qytetarët e intervistuar. Çështje që u përmendën nga 63.1% e të anketuarve ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 42.6%, 35% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 29% si e katërta, e pesta qarkullimi i vështirësuar për persona me aftësi të kufizuara, e gjashta problemet me ujësjellës dhe e shtata ndërtimet e larta.

Në hulumtimin e dytë në çështjet e ndërlidhura me urbanizëm u shtua çështja e ndërtimeve pa

leje dhe shkatërrimi i qendrës historike. Sikurse në hulumtimin e parë, intervistuesit kërkuar nga të anketuarit që të identifikojnë katër çështjet kryesore që janë brengosëse për ta. Analiza e të dhënave tregon se katër çështje kryesore për qytetarë të Prizrenit janë: Bllokimi i trotuareve me makina 64.3%, ndërtimet pa leje 44.6%, mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 41.8% dhe e katërta shkatërrimi i qendrës historike të Prizrenit me 35.3%. Është me rëndësi të theksohet se rezultatet e tjera siç janë p.sh. problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuara dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara janë paraqitur si probleme edhe në hulumtimin e dytë dhe përqindjet janë të ngjashme.

Në hulumtimin e tretë, qytetarëve u janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit të Prizrenit, ku iu është kërkuar që ti zgjedhin 4 opsione nga ato që sipas tyre janë më të rëndësishme për t'u adresuar. Analiza është bërë për të gjitha opsionet ku si problem i parë është paraqitur bllokimi i trotuareve me makina me një përqindje prej 72.4%, e përcjellë nga ndërtimet pa leje me 44%, më pas mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 42%, me 18.6% janë problemet me infrastrukturë (kanalizimi dhe ujësjellësi), mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve është e 18.3% si dhe çerdhet për fëmijë me 17.6%.

Në hulumtimin e katërt, qytetarëve u janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit të Prizrenit dhe u është kërkuar që t'i zgjedhin 5 opsione nga ato që sipas tyre janë më të rëndësishme për t'u adresuar. Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga qytetarët janë: Bllokimi i trotuareve me makina (19%), mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet (15%), mungesa e parqeve publike (11%), ndërtimet pa leje (9%), si dhe mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve (8%).

Te çështja e parë e cila ka numrin më të madh të ankesave, “zënia e trotuareve”, qytetarët në 86% (327) janë përgjigjur se janë zënë nga makinat, ndërsa me vlera më të vogla ata kanë deklaruar se trotualet janë zënë nga shitoret me 4%, shitësit ambulantë me 4% dhe me gjëra tjera 5%. Nëse krahasohen tri hulumtimet e para, del se problemi akut i qytetit të Prizrenit ishte bllokimi i trotuareve.

Analiza për pensionistët

Në këtë hulumtim, rreth 12% (38) e të anketuarve ishin pensionistë apo të moshës mbi 65 vjeçare. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga pensionistët janë:

1. Ndërtimet pa leje - 18%
2. Bllokimi i trotuareve – 21%
3. Mungesa e korsive për biçikleta – 18%
4. Problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara – 23%
5. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet – 14%

Fig. 1.17: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale [Pensionistët]



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë 12% e mostrës së përgjithshme ishin mbi moshën 65 vjeçare dhe

këta të anketuar, përpos që u janë përgjigjur pyetjeve që janë raportuar më lartë, atyre u është kërkuar që nga një grup i çështjeve urbanistike të zgjedhin 3 çështje kryesore që janë më relevante për këtë grup moshë. 80% e të anketuarve mbi moshën 65 vjeçare mendon se mungon hapësira e dedikuar për takimin e më të moshuarve si çështje të parë, 50% bllokimin e trotuareve dhe me nga 30% është mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit dhe ndërtimet pa leje.

Në hulumtimin e dytë nga mostra që ishin pensionistë mbi moshën 65 vjeçare dhe katër çështje kryesore sipas kësaj popullate janë: bllokimi i trotuareve me makina 69.7%, vend takim për pensionist/hapësira rekreative 51.5%, ndërtimet pa leje 42.4% dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara si çështje e katërt me 33.3%.

Në hulumtimin e tretë me një përqindje prej 76 % ishte mungesa e vend takimeve për pensionistë/hapësira rekreative, e dyta me 44 % ishte bllokimi i trotuareve me makina si dhe e treta ishte qasja në institucionet shëndetësore me një përqindje prej 44%.

Në hulumtimin e katërt, pensionistët kanë raportuar se çështjet më problematike në lagjet e tyre është ajo e bllokimit të trotuareve – 19% (20), si dhe mungesa e vend takimeve për pensionistët/hapësira rekreative ku 18% (19) e popullatës së mostrës e kanë zgjedhur këtë si çështje problematike. Gjithashtu mungesa e hapësirave të gjelbra dhe parqeve publike janë çështje problematike për pensionistët.

Analiza për gratë

Në këtë hulumtim, rreth 57% (187) e të anketuarve ishin të gjinisë femërore. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga gratë janë:

1. Bllokimi i trotuareve – 26%
2. Problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara – 16%
3. Shkatërrimi i qendrës historike – 17%
4. Mungesa e korsive për biçikleta – 16%
5. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet – 18%

Fig. 1.18: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale [Gratë]



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve femra ishte 66% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 43.1%, 30.6% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 30.6% si e katërta, e pesta problemet për qarkullimin e qytetarëve me nevoja të veçanta, e gjashta mungesa e çerdheve për fëmijë ujësjellësi dhe e shtata ujësjellësi.

Në hulumtimin e dytë si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve femra ishte 58.5% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 50.4%, 40.6% ndërtimet pa leje, si e katërta problemet për qarkullimin e

qytetarëve me nevoja të veçanta 34.8% dhe e pesta shkatërrimi i qendrës historike të Prizren.

Në hulumtimin e tretë, 57% e mostrës kanë qenë femra mbi moshën 16 vjeçare dhe në pyetjet e dedikuara për këtë mostër si çështje e parë është përmendur siguria në rrugë me 62%, e dyta bllokimi i trotuareve me makina 60% dhe me 35% mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit.

Në hulumtimin e katërt, grupi i grave deklaroi se problemi i bllokimit të trotuareve gjithashtu vazhdon të mbetet një nga problemet kryesore, për 21% (55) të popullatës. Mirëpo, përveç kësaj mungesa e hapësirave të gjelbra me 15% (39) së bashku me parqet publike me 14% (38) janë 3 çështjet kryesore që i kanë gratë në komunën e Prizrenit.

Analiza për të rinjtë

Në këtë hulumtim, rreth 17% (56) e të anketuarve ishin të rinj apo të moshës nën 26 vjeçare. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga të rinjtë janë:

1. Bllokimi i trotuareve – 21%
2. Mungesa e korsive për biçikleta – 12%
3. Problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara – 18%
4. Mirëmbajtja jo e mirë e rrugëve – 11%
5. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet – 13%

Fig. 1.19: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale [Të rinjtë]



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë 24.9% e mostrës kanë qenë të rinj nën moshën 26 vjeçare, si tre çështje kryesore të zgjedhur nga të rinjtë janë si vijon në figurën e mëposhtme. Si çështje kryesore që është përmendur janë mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit, e dytë bllokimi i makinave me trotuare me 43.5% dhe e treta mungesa e hapësirave funksionale me teatër/kinema e përcjellë me të katërtën mungesën e hapësirave rekreative.

Në hulumtimin e dytë si çështje e parë u përmend bllokimi i trotuareve me makina me 42%, ndërtimet pa leje 39.5% si e dytë, mungesave e hapësirave kulturore dhe rekreative me 32.1% dhe e katërta mungesa e hapësirave të gjelbëruara.

Në hulumtimin e tretë, të rinjtë nga mostra e përgjithshme me pyetje të veçanta duhet të zgjidhnin 3 çështje kryesore si më problematike për ta. E para radhitet mungesa e hapësirave rekreative - 48.4%, e përcjellë nga bllokimi i trotuareve me makina me 41.8 % si dhe e treta është mungesa e hapësirave kulturore për koncert/kinema me 35.2%.

Në hulumtimin e katërt është marrë edhe mendimi i të rinjve të komunës dhe cilat janë 3 problemet kryesore urbanistike me të cilat ata

ballafaqohen më së shumti, dhe gjithashtu edhe tek grupi i të rinjve problemi i bllokimit të trotuareve kryeson me 19% (129) të të anketuarve. Mungesa e hapësirave të gjelbra dhe parqeve publike janë 2 çështje tjera me të cilat të rinjtë e Prizrenit ballafaqohen dhe rezultatet janë respektivisht 11% dhe 18%. Ndërsa çështja e mbingarkesës së shkollave me ndërrime ka rezultuar të jetë çështja më pak problematike me vetëm 2% (12) të të anketuarve.

Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme

Kur bëhet fjalë për nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme ata janë kërkuar që t'i vlerësojnë ato me 1 deri në 5 (numri 1 bën vlerësim shumë të dobët, ndërsa numri 4 vlerësim shumë të mirë) qytetarët janë shprehur sipas të dhënave më poshtë:

- Planifikimi urban – 67% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 3-4.
- Planifikimi rural – 73% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Mbrojtja e mjedisit – 67% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Arsimi parashkollor – 80% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Arsimi fillor dhe i mesëm – 80% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Spitalet – 56 % e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- Shërbimet e emergjencës – 62% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Qendrat e mjekësisë familjare – 70% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Aktivitetet rinore – 62% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Aktivitetet e kulturës – 64% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Aktivitetet e sportit – 65% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- Mirëmbajtja e rrugëve komunale – 69% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 3-4.

- m. Mirëmbajtja e rrugëve ndërkomunale – 75% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- n. Kontrolli dhe rregullimi i trafikut – 43% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- o. Transporti publik – 80% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- p. Ndriçimi publik – 77% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- q. Parkingjet – 74% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- r. Trotuaret – 75% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- s. Sistemi i kanalizimit – 74% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- t. Mbledhja e mbeturinave – 76% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 4-5.
- u. Furnizimi me ujë – 74% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 4-5.
- v. Furnizimi me rrymë – 84% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 4-5.
- w. Pastërtia në qytet – 86% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- x. Mirëmbajtja e varrezave – 66% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- y. Shërbimet sociale – 40% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- z. Përfaqësimi i grave në komunë – 72% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- aa. Përfaqësimi i minoriteteve etnike në komunë – 74% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- bb. Prokurimi publik – 71% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- cc. Shëndetësia publike – 67% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- dd. Trashëgimia kulturore – 70% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ee. Procedurat për pagesën e taksave – 69% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ff. Shërbimet postare – 82% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.


- gg. Parqet dhe sheshet – 66% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- hh. Asambleja komunale – 57% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ii. Administrata komunale – 65% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- jj. Menaxhimi i fondeve komunale – 51% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- kk. Kryetari i komunës – 53% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.

Çështjet me vlerësimet më të dobëta

Nga 37 çështjet e përshkruara më lartë, 3 me vlerësimin më të dobët janë:

1. Trotuaret – 75% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 45% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur)
2. Parkingjet – 74% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 41% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur).
3. Kryetari i komunës – 53% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 39% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur).

Fig. 1.20: Çështjet me vlerësimet më të dobëta




Çështjet me vlerësimet më të larta

Nga çështjet e listuara 3 prej tyre kanë marrë vlerësimet më të larta, dhe ato janë:

1. Mbledhja e mbeturinave – 76% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 19% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).

2. Furnizimi me rrymë— 84% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 15% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).
3. Furnizimi me ujë— 74% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 15% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).

Fig. 1.21: Çështjet me vlerësimet më të larta



Krahasimi me anketimet e mëhershme

Në hulumtimin e parë niveli më i ultë i kënaqshmërisë është raportuar për atë se çka është bërë për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta, e dyta për qarkullimin për këmbësorë, e treta për hapësirat kulturore, e katërta qytetarët nuk janë të kënaqur me atë që është bërë për ndërtimet pa leje dhe e pesta me mesatare më të ultë të kënaqësisë është raportuar për mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.

Në hulumtimin e dytë sikurse edhe në të parën më se paku qytetarët kanë qenë të kënaqur për atë se çka është bërë në lidhje me rregullimin e problemeve që kanë të bëjnë me qytetarët me nevoja të veçanta e pasuar nga ajo se çka është bërë lirim e trotuareve nga makinat, pastaj për ndërtimet pa leje dhe e katërta për atë se çka është bërë për mungesën e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit.


Në hulumtimin e tretë shihet se në niveli më i lartë i kënaqshmërisë lidhet me furnizimin me ujë 7.2%, e pasuar nga kanalizimi 6.8%, 6.6% me transportin publik, 6.6% me ndriçimin publik dhe

6% me mirëmbajtjen e rrugëve. Ndërsa niveli i ulët i kënaqshmërisë bie mbi çështjet si: ndërtimet pa leje 2.1%, mundësia e ofruar për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta 2.4%, ndërtimet e larta në qytet 2.8%, me mirëmbajtjen e trotuareve për parkim 2.8% dhe me 3.2% mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.

Në hulumtimin e katërt, qytetarët kanë raportuar se nivelin më të lartë të kënaqshmërisë e kanë me furnizimin me ujë, ku 66% e kanë vlerësuar nga 5-10, ndërsa 28% e kanë vlerësuar me 10 (shumë mirë), si dhe me cilësinë e ujit të pijshëm, ku 66% e kanë vlerësuar nga 5-10, ndërsa 27% e kanë vlerësuar me 10. Sa i përket çështjeve që shënuan kënaqshmërinë më të ulët, qytetarë kanë vlerësuar me numrin 1 mungesën e korsive/shtigjeve për biçikleta (59%), vështirësitë në qarkullim për personat me aftësi të kufizuara (51%), ndërtimet pa leje (45%), ndërtimet e larta në qytet (40%), si dhe mirëmbajtjen e trotuareve për parkim (40%).


Sa i përket pyetjes nëse qytetarët e përdorin transportin publik, 32% (96) kanë deklaruar se nuk e përdorin transportin publik, 22% (67) janë deklaruar se e kanë provuar njëherë transportin publik, 31% (94) kanë thënë se e përdorin atë disa herë gjatë muajit, 10% (21) disa herë gjatë javës, kurse vetëm 5% (15) e përdorin atë çdo ditë. 92% (300) e qytetarëve janë në dijeni se qyteti ka linja të transportit urban, kurse 8% (27) janë deklaruar negativisht për këtë.

Fig. 1.22: A e përdorni transportin publik lokal, nëse po sa shpesh?




Nga grupi i cili janë deklaruar se nuk e përdorin transportin publik, 50% (57) prej tyre nuk e përdorin sepse kanë makina, 36% (42) kanë thënë se kanë dëshirë të ecin vetë, 7 persona janë deklaruar se përdorin biçikletën, kurse 8 persona thonë se nuk u përshtate orari.

Fig. 1.23: Nëse Jo, cilat janë arsytet?




Kur janë pyetur mbi opinionet e tyre për gjendjen e monumenteve dhe pjesës historike të qytetit, 31% (101) prej tyre deklaruan se nuk janë në gjendje aspak të mirë, 61% (199) thanë se ato janë në gjendje mesatarisht të mirë, kurse vetëm 8% (27) u shprehën se janë në gjendje shumë të mirë.

Fig. 1.24: Si e vlerësoni gjendjen e monumenteve dhe qendrës historike të qytetit në përgjithësi?




Kur janë pyetur se kush mendojnë që është përgjegjës për shkatërrimin e qendrës historike/kulturore të qytetit, 66% (199) fajësuan komunën dhe institucionet lokale, 17% (49) mbajtën përgjegjësi institucionet lokale dhe qendrore, kurse 11% (34) drejtuan gishtin te vetë qytetarët.

Fig. 1.25: Kush sipas jush është përgjegjës për degradimin/shkatërrimin e qendrës historike të qytetit?



Rreth çështjes së shtëpive të vjetra në qytet në prag të rrënimit, të anketuarit shprehen në masë prej 80% (254) se ato duhen rinovuar dhe kthyer në shfrytëzim, 18% (55), thonë se ato duhen rrënuar, kurse vetëm 5 persona mendojnë që nuk duhet bërë asgjë. Në lidhje me vullnetin për të ndërmarrë diçka për këtë gjendje, 68% (202) e qytetarëve pohuan se do të kontribuonin me para po të ishte nevoja për restaurimin e këtyre shtëpive, kurse 32% (97) u shprehën negativisht.

Fig. 1.26: Çka mendoni se duhet bërë me shtëpitë e vjetra të qytetit në prag të rrënimit?




2. Rezultatet e hulumtimit në fshatra

Rezultatet që prezantohen në këtë raport pasqyrojnë mendimet këtyre tre fshatrave të Prizrenit siç i kanë shprehur në pyetësin e përgatitur nga EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me GC&DA. Mostra përbëhet nga 75 të anketuar që janë intervistuar në lokacione të ndryshme brenda këtyre fshatrave të Komunës së Prizrenit.

Informatat demografike

Përbërja e mostrës së hulumtimit përfshiu 52% (39) të pjesëmarrësve të gjinisë femërore dhe 48% (36) të pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore.


Fig. 2.1: Gjinia



Për t'i bërë rezultatet më të lexueshme, mosha e të anketuarve është e ndarë në 3 grupe. Prej këtyre, 23% (17) i përkasin grupmoshës prej 16-25 vjeç; 63% (47) i përkasin grupmoshës prej 26-64 vjeç, dhe grupi i fundit përbëhet nga personat

mbi 65 vjeç, të përfaqësuar në këtë anketë me 14% (11).


Fig. 2.2: Grupmoshat e participantëve



Arsimimi

Në masë të madhe, të anketuarit mund të konsiderohet se kishin përcjellë apo mbaruar shkollën e mesme me 9 deri në 13 vite shkollimi, duke përfshirë rreth 41% (31) të popullatës. Ndërkaq, 19% (14) prej tyre kanë përfunduar 14 deri në 18 vite shkollimi, kurse 39% (29) kanë vijuar shkollën fillore.

Fig. 2.3: Niveli i arsimimit të participantëve




Të ardhurat mujore

Sa i përket të ardhurave mujore, të anketuarit janë pyetur se sa të ardhura kanë pasur mesatarisht gjatë tre muajve të fundit. Duke i ndarë përgjigjet në grupe sipas normës tatimore të vendosur nga Administrata Tatimore e Kosovës, 56% (42) raportuan se kishin të ardhura nga 0 deri në 80 euro në muaj, 15% (11) kishin të ardhura nga 80 deri në 250 euro, 13% (10) raportonin se fitonin nga 250 deri në 450 euro,

kurse 16% (12) e popullatës fitonte më shumë se kaq.


Fig. 2.4: Të ardhurat mujore të të anketuarve



Rezultatet nga pyetjet profesionale të nxjerra nga pyetësi

Sipas rezultateve të nxjerra nga hulumtimi shihet se 28% (21) të të anketuarve kanë njohuri/informatë se fshati i tyre ka plan rregullues, 36% (27) prej tyre nuk kanë njohuri për këtë, kurse 36% (27) të tjerë mohojnë që fshati i tyre të ketë plan rregullues.


Fig. 2.5: A keni njohuri nëse lagja/fshati juaj ka Plan Rregullues?



Sa i përket pjesëmarrës së qytetarëve në aktivitete publike për zhvillimin e planeve rregulluese, të cilët kanë qenë të ftuar nga organet komunale personalisht apo përmes një ftese të përgjithshme, 83% (82) prej tyre nuk kanë qenë të ftuar në debate publike dhe 17% (13) kanë qenë të ftuar në këto debate. Sa i përket ftesave të ngjashme nga organizatat e ndryshme, 12% (9) kishin marrë një ftesë të tillë kurse 88% (66) raportuan të mos ishin ftuar. Nga


të anketuarit e ftuar, 4 kishin marrë pjesë në debate publike, 1 kishte vijuar takimet në lagje, kurse 8 qytetarë nuk i ishin përgjigjur ftesës.

Fig. 2.9: A jeni ftuar nga organet komunale/organizatat joqeveritare në ndonjë debat me një çështje tjetër të caktuar?



Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve në iniciimin e nismave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në lagjet e tyre, të anketuarit kanë deklaruar se 20% (15) kanë qenë pjesë e iniciativave për të bërë ndryshime në lagjet e tyre, ndërsa 80% (60) nuk e kanë bërë këtë gjatë viteve të fundit.

Fig. 2.10: A keni provuar personalisht apo në grup me qytetarët tjerë që të ndërmerrni ndonjë nismë për zgjidhjen e ndonjë problemi në lagjen/fshatin tuaj gjatë viteve të fundit?




Prej këtyre qytetarëve, 61 persona i janë përgjigjur pyetjes “Si i keni artikulluar nevojat e juaja në raport me organet komunale?” 3 qytetarë janë deklaruar se kanë nënshkruar petition drejtuar organeve komunale, 7 kanë shprehur shqetësimet e tyre në takime të

drejtpërdrejta me zyrtarët komunalë, 4 prej tyre i kanë shprehur opinionet e tyre në diskutime publike, kurse pjesa tjetër nuk kanë shkuar më tej në shprehjen e shqetësimeve të tyre.


Qytetarët kanë treguar edhe çfarë ka ndodhur me shqetësimet e tyre. 87% (65) prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pas ndonjë reagim nga komuna, 7% (5) u është premtuar se do të zgjidhet problemi por nuk ka pasur rezultate, 4 prej tyre shprehen se problemi është zgjidhur pjesërisht, kurse vetëm 1 person është deklaruar se problemi është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme.

Fig. 2.12: Cili ka qenë reagimi i komunës?




Kur qytetarët janë pyetur nëse kanë pas ndonjë mundësi që problemet e tyre t'i artikulojnë dhe paraqesin para kryetarit të komunës, 80 % (60) e tyre kurrë nuk kanë pasur rastin t'i paraqesin problemet e tyre para kryetarit ndërsa 20% (15) prej tyre janë deklaruar pozitivisht. Në pyetjen e njëjtë por për drejtorët e qeverisë komunale në vend të kryetarit të komunës, 88% (66) e qytetarëve janë deklaruar se nuk e kanë pasur rastin t'i shprehin shqetësimet e tyre, kurse vetëm 12% (9) kanë mundur t'ua kumtojnë drejtorëve të qeverisë komunale brengat e tyre.

Fig. 2.11: A keni pasur ndonjë mundësi që problemet e lagjes/ fshatit t'i paraqitni para kryetarit të komunës/drejtorëve të qeverisë komunale?



Sa i përket organizimeve/organizatave në lagje, 89% (67) e qytetarëve janë përgjigjur se nuk ekziston një formë e organizimit të qytetarëve të një lagjeje dhe 11% (8) prej tyre kanë thënë se ekziston një organizim i tillë. Ndërkaq, rreth 53% (40) e të anketuarve janë deklaruar se në lagjen/fshatin e tyre ekziston një këshill lokal, kurse 47% (35) prej tyre janë deklaruar negativisht.

Fig. 2.12: Në lagje, a ekziston ndonjë grup i organizuar/organizatë/këshill lokal që merret me adresimin e problemeve të lagjes/fshatit?




Ndërsa kur qytetarët janë pyetur nëse komuna inkurajon funksionimin e këshillave lokale në lagje, 25% (19) e tyre kanë deklaruar se komuna i inkurajon këto organizime kurse vetëm 5 qytetarë janë shprehur në mënyrë negative.

Sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike në lagje qytetarët kanë deklaruar se në 57% (42) të

rasteve ata i shfrytëzojnë ato disa herë gjatë muajit, 15% (16) disa herë gjatë javës, 7% (5) e bëjnë këtë për çdo ditë, kurse 21% (16) nuk i shfrytëzojnë hapësirat publike.

Fig. 2.13: A i frekuentoni hapësirat publike në qytet, nëse po sa shpesh?




Përqindja e qytetarëve të cilët janë anëtarë joaktivë në organizata të ndryshme është mesatarisht 9%, kurse afërsisht 91% kanë deklaruar se nuk i takojnë asnjë organizate.

Prej këtyre, anëtarë aktivë kanë pasur vetëm partitë politike me 3 qytetarë dhe 1 anëtar nga organizatat për të drejtat e njeriut.

Kur qytetarët janë pyetur se a kanë nënshkruar ndonjëherë peticion, 33% (25) prej tyre kanë deklaruar se kanë nënshkruar, 44% (33) kanë thënë se ndoshta do ta bënin, ndërsa 23% (17) prej tyre kanë deklaruar se nuk do ta bënin fare.

Sa i përket bashkëngjites në bojkot, 8% (6) kanë deklaruar se e kanë bërë, 23% (17) se ndoshta do ta bënin, dhe 69% (52) që nuk do ta bënin asnjëherë. Gjithashtu, edhe në pyetjen për pjesëmarrje në greva të punëtorëve, rezultatet janë respektivisht 11%, 52%, dhe 37%, kurse për pyetjen rreth pjesëmarrjes në demonstrata paqësore, rezultatet janë respektivisht 24%, 37%, dhe 39%.


Fig. 2.15: Pjesëmarrje e qytetarëve në nënshkrimin e peticioneve, bashkëngjites në bojkot, pjesëmarrjes në greva të punëtorëve, dhe pjesëmarrjes në demonstrata paqësore



Pyetje për të gjithë të intervistuarit

Pjesë e hulumtimit kanë qenë edhe disa pyetje gjithëpërfshirëse, objektive të cilave kanë qenë disa nga çështjet urbanistike të komunës së Prizrenit. Në këtë pjesë, qytetarëve u është kërkuar të zgjedhin 5 nga problemet më të rëndësishme, të cilat duhet të adresohen nga organet komunale.

Fig. 2.16: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale



Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga qytetarët janë:

6. Mungesa e çerdheve në lagje - 48%
7. Mungesa e hapësirave sportive – 38%
8. Mungesa e parqeve të gjelbëruara – 32%
9. Mungesa e lodrave për fëmijë – 32%
10. Mungesa e parkingjeve për makina – 17%

Analiza për pensionistët

Në këtë hulumtim, 11 nga të anketuarit ishin pensionistë apo të moshës mbi 65 vjeçare. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga pensionistët janë:

6. Mungesa e çerdheve në lagje – 5 persona
7. Mungesa e hapësirave sportive – 5 persona
8. Mungesa e parkingjeve për makina – 3 persona
9. Mungesa e lodrave për fëmijë – 3 persona
10. Problemet në furnizimin me ujë – 2 persona


Analiza për gratë

Në këtë hulumtim, 39 të anketuar ishin të gjinisë femërore. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga gratë janë:

6. Mungesa e çerdheve në lagje – 46%
7. Mungesa e hapësirave sportive – 34%
8. Mungesa e parkingjeve për makina – 27%
9. Mungesa e lodrave për fëmijë – 26%
10. Mungesa e ndriçimit publik – 16%

Fig. 2.18: Nga lista e çështjeve të mëposhtme urbanistike zgjidhni 5 çështje që janë më të rëndësishme që duhet të kenë një adresim nga organet komunale [Gratë]



Analiza për të rinjtë

Në këtë hulumtim, 17 të anketuar ishin të rinj apo të moshës nën 26 vjeçare. Analiza e njëjtë e problemeve më të shpeshta mund të kryhet vetëm për këtë grup.

Pesë çështjet të cilat janë adresuar më së shumti nga të rinjtë janë:

6. Mungesa e çerdheve në lagje – 8
7. Mungesa e hapësirave sportive – 7 persona
8. Mungesa e parqeve të gjelbëruara – 6 persona
9. Mungesa e lodrave për fëmijë – 6 persona
10. Mungesa e ndriçimit publik – 4 persona

Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme

Kur bëhet fjalë për nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me çështje të ndryshme ata janë kërkuar që t'i vlerësojnë ato me 1 deri në 5 (numri 1 bën vlerësim shumë të dobët, ndërsa numri 4 vlerësim shumë të mirë) qytetarët janë shprehur sipas të dhënave më poshtë:


- a. Planifikimi urban – 88% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 3-4.
- b. Planifikimi rural – 72% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.

- c. Mbrojtja e mjedisit – 51% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- d. Arsimi parashkollor – 64% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- e. Arsimi fillor dhe i mesëm – 82% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- f. Spitalet – 58% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- g. Shërbimet e emergjencës – 74% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- h. Qendrat e mjekësisë familjare – 76% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- i. Aktivitetet rinore – 56% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- j. Aktivitetet e kulturës – 55% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- k. Aktivitetet e sportit – 52% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- l. Mirëmbajtja e rrugëve komunale – 84% e qytetarëve e kanë vlerësuar me 3-4.
- m. Mirëmbajtja e rrugëve ndërkomunale – 89% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- n. Kontrolli dhe rregullimi i trafikut – 71% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- o. Transporti publik – 76% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- p. Ndriçimi publik – 69% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- q. Parkingjet – 83% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- r. Trotualet – 87% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- s. Sistemi i kanalizimit – 65% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 4-5.
- t. Mbledhja e mbeturinave – 73% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 4-5.
- u. Furnizimi me ujë – 54% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- v. Furnizimi me rrymë – 71% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- w. Pastërtia në qytet – 88% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- x. Mirëmbajtja e varrezave – 70% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- y. Shërbimet sociale – 60% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- z. Përfaqësimi i grave në komunë – 75% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- aa. Përfaqësimi i minoriteteve etnike në komunë – 82% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- bb. Prokurimi publik – 68% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- cc. Shëndetësia publike – 84% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- dd. Trashëgimia kulturore – 83% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ee. Procedurat për pagesën e taksave – 85% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ff. Shërbimet postare – 89% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- gg. Parqet dhe sheshet – 51% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 1-2.
- hh. Asambleja komunale – 71% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- ii. Administrata komunale – 78% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- jj. Menaxhimi i fondeve komunale – 57% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.
- kk. Kryetari i komunës – 56% e qytetarëve e kanë vlerësuar nga 3-4.

Çështjet me vlerësimet më të dobëta

Nga 37 çështjet e përshkruara më lartë, 3 me vlerësimin më të dobët janë:

- 4. Mirëmbajtja e varrezave – 70% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 51% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur)
- 5. Trotualet – 86% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 35% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur).
- 6. Spitalet – 58% e kanë vlerësuar nga 1-2, ndërsa 27% e kanë vlerësuar me 1 (aspak i kënaqur).

Fig. 2.20: Çështjet me vlerësimet më të dobëta**Çështjet me vlerësimet më të larta**

Nga çështjet e listuara 3 prej tyre kanë marrë vlerësimet më të larta, dhe ato janë:

4. Mbledhja e mbeturinave – 73% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 21% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).


VI. Përmbledhja e problemeve kryesore të evidentuara në qytet dhe fshatra**1. Problemet e përgjithshme dhe të përbashkëta në qytet dhe fshat**

Në përgjithësi, rezultatet e anketimit të pestë, edhe në vitin e katërt të realizimit të tij, në kuadër të analizës për Qytetin gjithëpërfshirës, i konfirmojnë dhe i përforcojnë të gjeturat e analizave të kryera në vitin 2013, 2014 dhe 2015. Respondentët shprehen jashtëzakonisht të pakënaqur me menaxhimin e qytetit nga komuna e Prizrenit. Kjo është më se e evidente nga numërimi i brengave dhe problemet e mëdha të identifikuar dhe të ilustruara në grafikonet që përmbledhin rezultatet e anketimit të pestë.

Bazuar në rezultatet e anketimeve të kryera në lagje të ndryshme të qytetit si dhe në fshatra, problemet kryesore dhe të përbashkëta për të dy kontekstet mund të përmbledhen në:

- Vazhdon të jetë numri shumë i vogël i qytetarëve të Prizrenit, që kanë

5. Sistemi i kanalizimit – 66% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 4% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).
6. Ndriçimi publik – 42% e kanë vlerësuar nga 4-5, ndërsa 8% e kanë vlerësuar me 5 (shumë i kënaqur).

Fig. 2.21: Çështjet me vlerësimet më të larta

informatë se mund të marrin pjesë në diskutime publike si dhe të kontribuojnë në hartimin e planeve urbane për lagjet, dhe qyteti në përgjithësi. Bazuar në respondentët e fshatrave të përfshirë në këtë anketim, e njëjta situatë përshkruhet edhe në zonat rurale.

- Si pasojë e infrastrukturës së papërshtatshme apo edhe mirëmbajtjes së munguar të rrugëve, edhe këtë vit dominojnë problemet me qasjen dhe lëvizjen e lirë dhe të papenguar në qytet, por edhe në fshat, për të gjithë qytetarët pavarësisht moshës, gjinisë dhe aftësisë;
- Vazhdon të jetë shqetësim akut i qytetarëve edhe këtë vit degradimi i hapësirës urbane, e në veçanti i qendrës historike, qoftë me anë të ndërtimeve pa leje, e sidomos me veprimet e fundit të rrënimave të shumta në zemër të Qendrës historike;

- Është evidente edhe mungesa e parqeve hapësirave të tjera publike të gjelbra si në qytet ashtu edhe në fshat.
- Pamundësia e lëvizjes me biçikleta, i cili si problem u aktualizua vitin e kaluar, vazhdon të jetë një nga problemet më të përmendura.
- Mungesa e vetorganizimit qytetar dhe këshillave, në nivel lagjesh a fshatrash, por edhe mospërkrahja e tyre nga ana e komunës.

Komunikimi jo i mirë i komunës me qytetarë dhe pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në diskutime publike

Qyteti gjithëpërfshirës promovon zhvillimin përmes pjesëmarrjes së barabartë, ku të gjithë pavarësisht racës, etnisë, fesë e gjinisë fuqizohen dhe u mundësohet që të marrin pjesë në mënyrë të plotë në planifikimin dhe vendim-marrjen. Një planifikim dhe qeverisje gjithëpërfshirëse do të ndikonte në: zvogëlimin e pabarazive dhe uljen e tensioneve sociale; inkorporimin e dijes, produktivitetit, kapitalit shoqëror dhe fizik të të varfërve dhe të të marginalizuarve në zhvillimin dhe planifikimin e qytetit.²

Sikurse në vitet e kaluara, në anketimin e sivjetmë del në pah çështja e pjesëmarrjes mjaft të ulët të qytetarëve në planifikim dhe vendimarrje për çështjet kyçe për vendet që i banojnë. Këtu duhet t'i rikthehemi A. Madanipour-it, sipas të cilit, qytetet duhet të ngrihen duke pasur parasysh parimin e barazisë

dhe drejtësisë (...), duhet të jenë vende të qasshme, të krijuara dhe të menaxhuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse ³, komponentë thelbësorë e së cilës janë pjesëmarrja qytetare. Janë disa aspekte, për pasojë e të cilave duket se pjesëmarrja qytetare në procese të vendimarrjes për çështjet e ndryshme në qytet është e ulët.

Nga anketimi, shihet se gjysma e qytetarëve të Prizrenit nuk kanë njohuri për ekzistimin e planeve urbane dhe ata që i kanë, i marrin ato kryesisht prej mediave dhe jo nga komunikimi i drejtpërdrejtë me komunën. Po ashtu është një numër shumë i vogël i qytetarëve që janë të informuar se mund të kontribuojnë mbi çështjet urbane në qytet.

Infrastruktura ligjore, pjesëmarrjen publike në procesin e planifikimit hapësinor e rregullon përmes ligjit për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës ⁴, por edhe me një Udhëzimin Administrativ ⁵. Edhe pse aty përkufizohen aspektet themelore të diskutimeve publike që duhet të organizohen nga autoritetet e planifikimit (MMPH ose komuna përkatëse), afatet ligjore dhe mënyra e informimit publik (kryesisht përmes medieve lokale të shkruara dhe elektronike, webfaqes së komunës, posterët, etj.), këto nuk mjaftojnë të shpërndajnë informatën te qytetarët, por edhe të mobilizojnë këta të fundit për të marrë pjesë në to. Arsyeja kryesore e kësaj duket se është fakti se këtë proces (të diskutimeve dhe shqyrtimeve publike) komunat në të shumtën e rasteve e bëjnë sa për sy e faqe – sa për ta përmbushur obligimin ligjor,

² Basha R., Planifikim Urban për Qytetarët 4, EC Ma Ndryshe, dhjetor 2013

³ Madanipour, A., Kapitulli 12, Whose Public Space? në Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development, Madanipour, A., ed., Routledge, New York, 2010, fq. 238 Amazon Kindle edition, marrë nga Analiza – Planifikim Urban për Qytetarët, EC Ma Ndryshe, 2014

⁴ Kreu IV, neni 20, Ligji nr. 04/ L-174 të vitit 2013.

⁵ Udhëzimin Administrativ për Përgjegjësitë dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, <http://www.mmph-rks.org/sq/Projekt-aktet-normative-per-konsultime-publike/UDHEZIM-ADMINISTRATIV-MMPH-NR-PER-PERGJEGJESITE-DHE-PROCEDURAT-PER-PJESEMARRJEN-E-PUBLIKUT-NE-PLANIFIKIM-HAPESINOR-827>

duke mos qenë realisht të interesuar për të marrë përgjigjet, reagimet dhe vërejtjet e qytetarëve për projektet, planet dhe intervenimet e ndryshme të cilat i kryejnë në qytet. Diskutimet publike, në mënyrën se si mbahen në Kosovë, nuk janë aspak formë e bashkëpunimit me komunitetin në planifikimin e qyteteve. Ato zakonisht mbahen në forma plenare, me një auditor të kufizuar, sepse format e lajmërimit që përdoren nga administrata lokale nuk janë efektive. Në takimet plenare, nga të pranishmit (me shumicë absolute të gjinisë mashkullore), pritet të dëgjohet ndonjë koment i izoluar mbi fazën finale të planit, i cili prezantohet në medime jo fort të kuptueshme për ta. Kështu, nuk mbërrihet as të merret ndonjë kërkesë apo nevojë specifike e komunitetet banues të zonës që planifikohet, por as ndonjë koment substancial rreth planit, i cili prezantohet para publikut. Me këtë planet, me ta marrë vizën e mbajtjes së diskutimit publik, shkojnë në kuvend dhe aprovohen.

Andaj, me qëllim të rritjes së transparencës së proceseve planifikuese, informimi duhet të bëhet përmes kampanjave më të gjera informuese dhe me forma alternative informative, meqë mediumet e përcaktuara me ligj mund të mos i arrijnë të gjithë qytetarët që do të mund të kontribuonin në proceset planifikuese.

Por, arritja e informatës deri te qytetari nuk mjafton për ta bindur atë dhe ta mobilizojë që të kontribuojë. Zakonisht, mobilizimi i qytetarëve duhet të bëhet përmes këshillave të lagjeve dhe organizatave që punojnë me komunitetet e caktuara. Këto të fundit janë jashtëzakonisht të rëndësishme për mobilizimin e grupeve të marginalizuara të komunitetit që mungojnë në këto diskutime (gratë, rinia, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet pakicë, etj.).

Problemi i mobilizimit të qytetarëve vetëm përmes ftesave për diskutime publike është edhe për shkak se besueshmëria e zgjidhjes së problemeve nga strukturat komunale ka rënë. Nga anketa del se një numër jashtëzakonisht i vogël i problemeve që qytetarët kanë arritur t'i

shpalosin para ndonjë zyrtari komunal, kanë gjetur çfarëdo zgjidhjeje apo zgjidhje të kënaqshme.

Mungesa e këshillave apo çfarëdo organizimi të ngjashëm në lagje dhe mospërkrahja e tyre nga ana e komunës, është edhe një aspekt tjetër problematik që vihet në pah nga ky anketim. Një gjë e tillë tregon se qytetarët nuk kanë mundësi të adresojnë problemet e tyre në nivel të lagjes, por edhe të organizohen për të ndërmarrë ndonjë veprim në lagje. Në anën tjetër, mungesa e këshillave, ia bën të pamundur komunës që të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të marrin informata të dorës së parë për shqetësimet e banorëve të lagjeve të caktuara. Anketa po ashtu tregon se qytetarët vështirë dhe rrallëherë kanë rast t'i takojnë udhëheqësit e dikastereve komunale, e aq më pak kryetarin, kështu që derë e vetme për t'u ankuar u mbetet takimi në diskutime dhe shqyrtime publike, të cilat nuk i frekuentojnë në numër të madh, meqë informata për to nuk i arrin. Qytetarëve iu mungon informata mbi planet urbane, informata për mundësinë e dhënies së kontributit të tyre qytetar në proceset planifikuese.

Andaj, për pasojë të gjithë këtij procesi të planifikimit me shumë të meta, por edhe për shkak të kuadrit ligjor që zbatohet sa për sy e faqe, si dhe për shkak të mungesës së komunikimit në veçanti me komunitetet më të marginalizuara, vendbanimet tona dhe i gjithë mjedisi i ndërtuar mbetet problematik për nga mosfunksionimi i mirë i infrastrukturës, hapësirë publike jo funksionale, barrierat arkitektonike për komunitetet që kanë mobilitet të kufizuar, dhe në përgjithësi qytete përjashtuese më parë se sa gjithëpërfshirëse.

Rekomandim:

Planifikimi urban është procesi më i ndjeshëm i vendimmarrjes komunale që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së qytetarëve. Duke u nisur nga kjo, si dhe nga të gjitha parregullsitë që u përmendën më lart, dhe me qëllim të rritjes

cilësore të pjesëmarrjes qytetare në diskutime publike dhe hartimin e planeve urbane, rekomandojmë si vijon:

- *Komuna të krijojë një platformë digjitale për pjesëmarrje publike⁶, përmes të cilës qytetarët do të shpalosin para autoriteteve të komunës, shqetësimet dhe problemet që i kanë me çështjet e ndryshme urbanistike, shërbimet publike, etj.*
- *Komuna t'i publikojë në webfaqen e vet të gjitha planet hapësinore në fuqi.*
- *Komuna të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile për organizimin dhe facilitimin e diskutimeve publike rreth planeve urbane, edhe pse me ligjin për planifikimin hapësinor të Kosovës, përgjegjësia për organizimin e diskutimeve publike në lidhje me planet hapësinore i takon autoriteteve (lokale dhe qendrore). Rëndësi e veçantë t'i kushtohet targetimit të grupeve të marginalizuara të komunitetit për t'u siguruar në pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të barabartë në procesin e hartimit të planeve urbane.*
- *Diskutimet publike të zhvillohen në grupe të vogla (15-20 vetë) brenda grupeve të caktuara të komunitetit (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, lagjet informale, ambientalistët, artistët, etj.). Brenda këtyre grupeve, komponenta e barazisë gjinore dhe e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të konsiderohen prioritet,*
- *Të sigurohet që ftesa të shpërndahet minimum 8 ditë përpara mbajtjes së*

diskutimeve publike (duke e respektuar afatin kohor të caktuar me ligjin për planifikim hapësinor). Kjo ftesë të bëhet përmes mënyrave që tashmë përcaktohen me ligj, por edhe ftesë përmes SMS-ve dhe e-mailave; përmes organizatave të komunitetit tek anëtarësitë e tyre, si dhe platformave të medieve sociale. Bashkë me ftesën për diskutimin publik, të shpërndahet një përmbledhje tekstuale dhe grafike (1 fq. A4) mbi planin urban në diskutim. Në web-faqen e komunës, para diskutimit të publikohet përmbledhja grafike dhe tekstuale e lagjes dhe propozimit për të (varësisht prej fazës së planifikimit që do të diskutohet).

- *Gjatë diskutimeve publike, përveç në mënyrë grafike e tekstuale, të prezantohen edhe me anë të maketave të një shkallë të lexueshme, lagjja, vizioni dhe intervenimi i propozuar (varësisht prej fazës së planifikimit që vihet në diskutim).*
- *Diskutimet publike të realizohen në dy forma: Diskutimi plenar (një në fillim të fazës planifikuese dhe një në përmbyllje) dhe diskutimi në formën e tryezës së rrumbullakët (të ndarë në grupe të komunitetit). Gjatë organizimit të diskutimit, të gjithë pjesëmarrësit duhet të jenë ulur në plan të barabartë diskutimi,*
- *Përveç takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, drafti i planit urban (pjesa grafike dhe tekstuale) të vendosen në web-faqen e komunës, për t'u ofruar mundësi komentimi qytetarëve që nuk kanë mundësi të jenë prezent fizikisht në*

⁶ Një platformë e tillë tashmë është krijuar nga komuna e Prishtinës, <https://platformadigjitale.com/Prishtina>

diskutimet publike.

- *Për të lehtësuar komunikimin me qytetarë në lagje, dhe me qëllim të stimulimit të organizimit të komuniteteve në lagje, Komuna të përkrahë krijimin e këshillave të lagjes. Në këtë drejtim, përkrahje në organizimin e komunitetit duhet të japin edhe organizatat e shoqërisë civile.*

Niveli jo i kënaqshëm i vetorganizimit qytetar

Vetorganizimi dhe ndërmarrja e iniciativave qytetare rreth problematikave të ndryshme urbane dhe shoqërore po ashtu duket të mos jetë në nivel të kënaqshëm. Në një situatë kur qytetarët nuk kanë ku t'i adresojnë problemet, por edhe kur janë të painformuar për mundësinë e dhënies së kontributit të tyre në planifikim dhe në procese të ndryshme vendimmarrëse, është më se e rëndësishme që të ndërtohet një qytetari aktive. Me një emancipim të tillë qytetar, me njohuri mbi mjetet e veprimit qytetar dhe politik për ngritjen e çështjeve që e shqetësojnë komunitetin, shumë probleme urbane të neglizhuara nga komuna nuk do të vazhdonin të mbeteshin të pa adresuara nga kjo e fundit. Shoqëria civile e luan rolin e vet të rëndësishëm ndërmjetësues, për t'i përcjellë këto shqetësime të qytetarëve te komuna, me çka në njëfarë mënyre e vendos në vend hallkën e munguar të komunikimit në mes të komunës dhe qytetarëve. Shoqëria civile luan rol të rëndësishëm emancipues dhe të ngritjes së një qytetarie aktive në komunitet. Mes tjerash, organizatat e shoqërisë civile, janë të rëndësishme edhe për punën avokuese që e bëjnë në lidhje me grupet e marginalizuara të komunitetit.

Përfundimisht, rëndësia e ndërtimit të një qytetarie aktive është e shumëfishtë. Mes tjerash, ajo e përforcon ndjenjën e identitetit të komunitetit për vendin. Për qytetarët aktivë, demokracia nuk është më një term abstrakt: ata

e zbulojnë shkathtësinë e vet për të bërë ndryshime, pasi ta kenë provuar vlerën e pjesëmarrjes në vendimmarrje⁷. Me punën e tyre, qytetarët aktivë zhvillohen përtej ndërgjegjësimit rreth një problemi specifik, drejt përqafimit të një mendësie publike dhe të një angazhimi më të gjerë për të mirën e komunitetit dhe qytetit në përgjithësi.

Rekomandim:

Përderisa dominon një situatë siç u përshkrua më lartë, organizatat e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë t'i përcjellin shqetësimet e qytetarëve te komuna, duke e vendosur në vend hallkën e munguar të komunikimit në mes të komunës dhe qytetarëve. Shoqëria civile me këmbëngulësi duhet të vazhdojë të ketë rol të rëndësishëm emancipues dhe të ngritjes së një qytetarie aktive në komunitet, e në veçanti te komunitetet e marginalizuara.

Organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të pranishme në lagje dhe në fshatra dhe të iniciojnë mbledhjen e komunitetit dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme që ndërlidhen me cilësinë e jetës në lagje, me infrastrukturë, shërbime publike, planifikim urban, etj. Përmes këtyre organizimeve, shoqëria civile do të mund të përhapte informatat te komuniteti në lidhje me planet urbane në fuqi dhe projektet tjera të komunës. Nga këto organizime do të mund të dilnin propozimet dhe kërkesat që pastaj do të adresoheshin te zyrtarët e drejtorive relevante në komunë.

Çështjet që ndërlidhen me hapësirat publike

Të lëvizësh në qytet është shumë më shumë sesa të marrësh makinë apo autobus për përmbajtje të caktuara. Edhe kësaj radhe, si në anketimet e mëhershme, përgjigjet e qytetarëve nga lagjet e qytetit, por edhe nga fshatra dëshmojnë shkallën e lartë të zaptimit të trotuareve dhe sipërfaqeve

⁷ http://newcity.ca/Pages/citizen_learning.html

të tjera publike si fenomen i kudogjendur në Prizren.

Trotualet janë ato pjesë të hapësirës publike në qytet, të cilat, pos që e krijojnë sipërfaqen e përshtatshme për ecje në publik, u ofrojnë siguri këmbësorëve nga aksidentet e trafikut. Trotualet e mira janë ato të cilat i akomodojnë së paku dy persona të rritur që të mund të ecin përbri njëri-tjetrit dhe janë të lira nga elementet horizontale dhe vertikale që e vështirësojnë ose pengojnë krejtësisht lëvizjen. Komuna e Prizrenit, krahas promovimit të lëvizjes në qytet në këmbë dhe me biçikletë, dhe zgjerimit të rrjetit të rrugëve dhe shtigjeve këmbësorike, do të duhej të kujdesej për krijimin e pikëtakimeve, hapësirave publike të madhësive të ndryshme, parqeve e zonave të gjelbëruara. Pikërisht mungesa e zonave të gjelbëruara, nga anketimi në qytet dhe fshat, del si shqetësim madhor i qytetarëve. Në qytetin e Prizrenit ka tërësi të mëdha gjelbërimi, sikurse Marashi dhe Parku i qytetit, por për shumë qytetarë këto tërësi të gjelbra mund të jenë larg vendeve që i banojnë. Andaj, nevojitet një decentralizim i sipërfaqeve të madhësive dhe formave të ndryshme në tërë qytetin. Me këtë, sipërfaqet e gjelbra me hijen e këndshme gjatë verës, por edhe si hapësira për rekreim edhe relaksim të të gjithë qytetarëve do të gjendeshin në brendi të lagjeve. Këto të gjitha janë edhe aspekte të domosdoshme të një qyteti të qëndrueshëm.

Çuditërisht, edhe kësaj radhe për qytetarët e Prizrenit një nga pyetjet më pak shqetësuese del të jetë transporti publik. Nga anketimi lë të nënkuptohet se shumë nga ta për relacione të shkurtra dhe të gjata përbrenda qytetit përdorin automjetet personale. Në një qytet të shtrirë si Prizreni, por edhe për ta ndërlidhur qendrën me periferinë e gjerë të saj, është më se i nevojshëm një rrjet i zgjeruar dhe funksional i transportit publik. Janë komuniteti i pensionistëve, i grave, si dhe ai i personave me aftësi të kufizuara që

tradicionalisht më shumë lëvizin me transport publik. E në anën tjetër, promovimi i lëvizjes për të gjithë me transport publik do të kishte efekte në zvogëlimin e numrit të makinave në rrugë, zvogëlimin e ndotjes së ajrit, lirin e trotuareve, promovimin e mënyrave të tjera të qëndrueshme të lëvizjes në qytet, si ecjes dhe lëvizjes me biçikletë, etj.

Rekomandim:

Duke qenë se trotualet në rrugët e qytetit të Prizrenit janë sipërfaqe në pronësi publike dhe se çfarëdo veprimi i zaptimit të tyre nga qytetarë apo pronarë lokalesh të papërgjegjshëm është shkelje ligji dhe pengim dhe vështirësim i rrjedhës normale të lëvizjes këmbësorike në qytet në përgjithësi, Inspektorati i Komunës së Prizrenit duhet të ndërmarrë masa konkrete për largimin e të gjitha pengesave si dhe lirin e trotuareve për shfrytëzim të qytetarëve.

Prioritet i komunës duhet të jetë ngritja e një agjende të shëndetit publik për qytet dhe fshat. Brenda kësaj agjende, përpos trajtimit të çështjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, sigurimit të ushqimit të shëndetshëm, etj., hyjnë edhe ofrimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe promovimi i lëvizjes në këmbë dhe me biçikletë.

Hapësirat e gjelbra urbane ndihmojnë në luftimin kundër sëmundjeve urbane dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Këto hapësira të gjelbra variojnë në madhësi, mbulueshmëri vegjetacioni, pasuri të llojeve, cilësisë mjedisore, afërsisë me transportin publik dhe me shërbime të tjera. Përpos parqeve, këto sipërfaqe të gjelbra përfshijnë edhe fushat e sportit, brigjet e lumit, shtigje të gjelbëruara, kopshtet e lagjeve, drunjtë e rrugëve, etj. Sipërfaqet publike të gjelbra duhet të jenë në qendër të secilës lagje, dhe jo më larg se 5 minuta ecje në këmbë për banorët e lagjes. Andaj, qasja dhe afërsia janë faktor i rëndësishëm për t'u

konsideruar gjatë planifikimit të gjelbërimit urban.

2. Problemet e veçanta që dalin nga anketimi në lagje dhe qytet

Shkatërrimi i qendrës historike

Në pyetjen në lidhje me problemet më mëdha të qytetit të Prizrenit, qytetarët në një masë të madhe radhitën shkatërrimin e qendrës historike të qytetit. Ndër problemet madhore radhiten edhe ndërtimet pa leje, të cilat janë evidente në qendrën historike të Prizrenit, dhe të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shqetësimeve rreth shkatërrimit të Qendrës historike. Këto shqetësime këtë vit janë më aktuale se më parë për shkak të një numri të madh të rrënimave të shtëpive përbrenda zonës së ngushtë historike. Këto shqetësime i ka shtuar edhe më shumë edhe rasti tragjik i vajzës së vogël Xheneta Gashit nga rrëzimi i një pjese të një shtëpie gjysmë të rrënuar në zemër të Qendrës historike. Sipas anketimit, qytetarët e Prizrenit si fajtor kryesor për shkatërrimin e qendrës historike e radhisin komunën dhe institucionet lokale.

Prizreni, edhe pse, ndryshe prej qyteteve të tjera, ka plan të konservimit për Qendrën historike, por edhe ligj për këtë zonë të veçantë, normalisht do të duhej të siguronte dhe të përcaktonte rregullat për ndërtim, zhvillim, por para së gjithash mbrojtje në këtë zonë, sot, 7 vite pas aprovimit të këtij plani, në qendrën historike të Prizrenit, degradimi nuk ndalon. Institucionet e nivelit lokal dhe qendror, QRTK-ja, por edhe KZM-ja, deri më tani kanë dështuar në parandalimin e dëmtimit dhe shkatërrimit të pjesëve të tëra të kësaj zone. Po ashtu, ata kanë dështuar edhe në

implementimin e normativave të përcaktuara për ndërtim në këtë zonë⁸.

Rekomandim:

Fillimisht duhet ndërmarrë veprime urgjente për ndërprerjen e shkatërrimit të qendrës historike. Institucionet e të gjitha niveleve duhet të shtojnë nivelin e përgjegjësisë së tyre dhe angazhimet në drejtim të ruajtjes, konservimit dhe promovimit të vlerave të rralla të trashëgimisë së qytetit të Prizrenit. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me organet tjera duhet të ndërmarrë veprime emergjente për parandalimin e shkatërrimit të mëtejshëm të objekteve të vjetra në Qendrën Historike dhe të investojë në konservimin e tyre. Një nga këto veprime emergjente është edhe alokimi i mjeteve për intervenime emergjente në Qendrën historike të Prizrenit nga ana e MKRS-së dhe Kuvendit të Kosovës. Organet e rendit dhe gjyqësori duhet të ndjekin penalisht rastet e dëmtimit të trashëgimisë kulturore (siç edhe parashihet me ligj). Gjyqësori nuk duhet t'i zhgagitë këto raste, meqë një situatë e tillë vetëm se i inkurajon të tjerët që të ndërmarrin veprime shkatërruese në Qendrën historike të Prizrenit.

Ndërsa, për të siguruar implementimin dhe zhvillimin e kësaj zone, duhet plani i menaxhimit i kësaj zone, një grup punues ndërsektorial për të cilin tashmë është formuar dhe janë në proces të hartimit të këtij plani. Në anën tjetër nevojitet edhe aktivizimi i inspektorëve të trashëgimisë, të cilët do të monitoronin në baza të rregullta aktivitetet ndërtimore, apo edhe intervenimet e tjera që zhvillohen në këtë zonë.

Problemet e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara

⁸ EC Ma Ndryshe, Zhdukja e gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës, shtator 2011,

Barrierat e shumta arkitektonike në qytetin e Prizrenit që pamundësojnë lëvizjen e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, paraqesin një nga problemet që radhiten si më kritiket nga qytetarët e anketuar. Qasja për persona me aftësi të kufizuara paraqet të drejtën elementare për lëvizje të lirë dhe jetë të pavarur, që garantohet me Konventën Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Qasja për persona me aftësi të kufizuara, sipas Tanya Titchkosky⁹ lidhet ngushtë me organizimin shoqëror të pjesëmarrjes qytetare, por edhe me ndjenjën e përkatësisë ndaj një vendi. Sipas saj, qasja për persona me aftësi të kufizuara jo vetëm se duhet të kërkohet, por për të duhet edhe të luftohet, ajo duhet të sigurohet ligjërisht, fizikisht të matet dhe të mbrohet politikisht. Ajo duhet të kuptohet si një formë komplekse e perceptimit që organizon marrëdhëniet socio-politike ndërmjet njerëzve në hapësirën sociale. Disa nga problemet kryesore që paraqiten në qytet dhe në ndërtesa dhe që pengojnë lëvizjen e lirë dhe të pavarur të personave me aftësi të kufizuara janë mungesat e rampave, ose rampa me pjerrtësi të papërshtatshme në institucione publike; mungesa e tualeteve për PAK në këto institucione; mungesa e tualeteve publike për PAK; mungesa e transportit publik të qasshëm; barrierat e ndryshme në infrastrukturë, trotuare dhe hapësirë publike në përgjithësi (zaptimi i trotuareve nga makina, nga mallra të ndryshëm, mobiluar lokalesh), mungesa e pjerrinave në trotuare, mungesa e fushave taktore për të verbrit, etj. Barrierat arkitektonike që u përmendën lartë nuk pengojnë vetëm lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, por edhe të moshuarve, prindërve me fëmijë, apo edhe

secilin njeri në një moment apo situatë të caktuar të jetës. Andaj, eliminimi i këtyre barrierave do të ndikonte jo vetëm në integrimin dhe pjesëmarrjen më të madhe të këtij komuniteti të marginalizuar në jetën e qytetit, por edhe përmirësimin e cilësisë së jetës edhe për një popullsi të gjerë të qytetit në përgjithësi.

Rekomandim:

Komunës së Prizrenit i rekomandohet formimi i komisioneve profesionale për hartëzimin e të gjitha barrierave arkitektonike në qytet, dhe hartimin e rregulloreve për eliminimin e barrierave arkitektonike në ndërtesa dhe hapësira publike të qytetit¹⁰, por edhe rregullore qyteti për projektim pa barriera, i cili do të jetë i bazuar në parimet e dizajnit universal.

Duhet ndërtuar mekanizma të implementimit të udhëzuesve administrativ dhe rregulloreve për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në mjedis të ndërtuar. Ndër të tjera, këto mekanizma do të përfshinin detyrimin e dorëzimit të elaboratit të qasjes gjatë aplikimit për leje të ndërtimit; përcjelljen e zbatimit të këtyre kushteve teknike në terren; si dhe të mos lejohet pranimi teknik i punëve publike pa u siguruar se elementet qasëse në ndërtesa nuk janë realizuar sipas standardeve në fuqi.

Të sigurohet prania e pjesëtarëve të komunitetit PAK në debate dhe diskutimeve publike për çështje urbanistike, për t'i inkuadruar nevojat dhe propozimet e tyre për infrastrukturën, rregullimin urbanistik të qytetit dhe qasjen në ndërtesa, etj.

Mungesa e shtigjeve për biçikleta

⁹ Titchkosky, T., The Question of Access: Disability, Space, Meaning, University of Toronto Press, 2011

¹⁰ Basha, R. Raport i hulumtimit mbi barrierat arkitektonike në ndërtesat publike në qytetin e

Prishtinës, Prishtina për të gjithë, publikuar nga Handikos, nëntor 2016

Sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe mungesa e shtigjeve të biçikletave dhe me këtë vështirësia e lëvizjes me këtë mjet nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit shfaqet si problematike. Prizreni ka traditë të lëvizjes me biçikletë, falë topografisë së përshtatshme, dhe qytetit që është i zhvilluar në shkallë humane. Tendencia e lëvizjes me biçikletë duket përherë e më shumë rritet, përkundër pengesave të mëdha që paraqiten në qytet, sikurse trafiku i dendur, por edhe infrastruktura jo e përshtatshme. Në frymën e zhvillimit të qëndrueshëm të qyteteve, promovohen mënyrat e qëndrueshme të lëvizjes, e që janë lëvizja në këmbë, me biçikletë dhe me transport urban. Lëvizja me biçikletë, mes tjerash kontribuon edhe në shëndetin e njeriut, duke mos prodhuar gazra të dëmshme, por edhe për vetë ngasësit e biçikletave, të cilët përfitojnë në mbajtjen e një trupi më të shëndetshëm.

Rekomandim:

“Një biçikletë më shumë në rrugë është baras me një makinë më pak”.

Çiklizmi është transporti urban me efikasitet më të madhe energjie, si dhe ka potencial më të lartë të zvogëlojë shpenzimin e energjisë dhe të rrisë jetëgjatësinë e qytetarëve. Për këtë arsye është më se e domosdoshme të promovohet kultura e çiklizmit. Ndërsa, duke marrë si shembull shumë qytete evropiane ku lëvizja me biçikletë është shndërruar në një formë të transportit standard, me infrastrukturë mirë të shtruar krahas asaj që akomodon transportin urban dhe automjetet personale, komuna e Prizrenit duhet të hartojë një plan të ri mobiliteti, përmes të cilës do të promovohet lëvizja me transport urban dhe biçikletë, ndërsa do të limitohet përdorimi i makinave personale. Ky plan mobiliteti do të parashihte në veçanti shtrirjen e një rrjeti të gjerë të shtigjeve të biçikletave, ndërsa numri i makinave do të kufizohej dukshëm në qendër të qytetit. Me shtigje të biçikletave në qytet, edhe biçiklistët do t'u nënshtroheshin rregullave të

komunikacionit, makinat do ta rrisnin kujdesin dhe zvogëlonin shpejtësinë për shkak të pranisë së numrit të madh të biçikletave në komunikacion, me çka do të rritej siguria në trafik brenda qytetit.

1. Problemet e veçanta që dalin nga anketimi në fshatra

Mungesa e institucioneve parashkollore

Sa i përket fshatrave, një nga problemet më kritike të radhitura nga respondentët është mungesa e institucioneve parashkollore. Problemi i mungesës së institucioneve parashkollore publike në nivel fshati është problem i përgjithshëm në Kosovë. Për shkak të faktorëve të shumtë shoqëror dhe ekonomik, këto institucione janë më se të domosdoshme në fshatra dhe rrethe në përgjithësi. Mungesa e çerdheve në fshat i mban gratë larg punës. Andaj për t'iu mundësuar atyre të përfshihen në tregun e punës, komuna me ndërtimin e këtyre institucioneve do të ofronte zgjidhje për kujdesin ditor të fëmijëve.

Mungesa e hapësirave për sport

Ky problem u evidentua në veçanti në përgjigjet e respondentëve të rinj nga fshatrat. Hapësira publike në fshatra është gati se jo ekzistuese. Për argëtim dhe shijim të aktiviteteve publike, banorët e fshatrave zakonisht i drejtohen qytetit. Ndërtesat dhe hapësira rekreacioni, sporti dhe kulture, do të pasuronin hapësirën dhe jetën publike në fshat.

Mungesa e ndriçimit publik

Në një pjesë të madhe të fshatrave të Kosovës mungon ndriçimi publik. Në anketim, ky problem vihet në pah në veçanti nga respondentet gra. Nga anketimet e mëhershme në qytetin e Prizrenit, gratë zakonisht e vinin në pah problemin e mungesës së ndriçimit publik, që ndërli dhe me ndjenjën e sigurisë të lëvizjes në

orë të mbrëmjes, por edhe me sigurinë e fëmijëve që ktheheshin nga shkolla në orët e pasditeve të vona gjatë stinëve të vjeshtës dhe të dimrit. Ndriçimi publik pos që e rrit ndjenjën e përgjithshme të sigurisë, në veçanti pranë rrugëve me komunikacion automobilistik, ai e bën të mundur edhe gjallërimin e hapësirës publike gjatë mbrëmjeve.

Konkludim:

Problemet që ndërlidhen me menaxhimin urban të Prizrenit dhe në fshatrat e kësaj komune në përgjithësi janë të shumta. Shumë prej tyre ndërlidhen ngushtë me praktikën aktuale të planifikimit dhe vendimmarrjes për hapësirën urbane. Procesi i planifikimit prej pas luftës e deri më tani, kryesisht kryhet nga profesionistët, që hartojnë plane, pa komunikuar fare me komunitetin për të cilin ato plane përgatiten. Planet e përfuara kësisoj, kryesisht nuk reflektojnë ndjenjën e vendit dhe të pronësisë për popullatën banuese. Për pasojë, është më se evidente se qyteti dhe hapësira publike, në veçanti, trajtohen me neglizhencë, si nga qeverisja lokale, e në veçanti nga qytetarët, meqë vendimet për hapësirën urbane merren ekskluzivisht nga lartë, pa pasur dialog të mirëfilltë me ta – shfrytëzuesit e atyre hapësirave.

Një qytet si e mirë e përbashkët, që mëton zhvillim të qëndrueshëm, ngrihet nga një shoqëri gjithëpërfshirëse përmes proceseve pjesëmarrëse. Janë të shumtë individë, grupe dhe organizata që shtrojnë kërkesa dhe kanë pretendime mbi qytetin. Marrja në konsideratë të veç njëres anë, plotëson dëshirat për ekskluzivitet që secila prej tyre mund të ketë në një hapësirë urbane. Për t'i evituar veprimet që

mund të prodhojnë situatat që u lartpërmendën, planifikimi i qytetit duhet të ndërtohet në kryqëzim të pretendimeve dhe kërkesave të grupeve të ndryshme. Kërkesat e këtyre grupeve mund të jenë kundërthënëse, andaj zgjidhjet për një qytet të drejtë që do t'iu shërbente të gjithëve duhet të negociohen. Këto negociata mund të realizohen në mënyrë të suksesshme vetëm përmes proceseve gjithëpërfshirëse të projektimit dhe zhvillimit të qytetit.¹¹

Nëse caku i secilës qeveri lokale është zhvillimi dhe prosperimi i qytetit dhe rritja e atraktivitetit të tij për të gjithë qytetarët, proceset e qeverisjes duhet të ndryshojnë për t'u arritur këto caqe. Për këtë duhet të arrihet një konsensus, të zhvillohen proceset e konsultimeve publike, dhe reforma institucionale, me qëllim të fundmë ngritjen e qytetarisë dhe zgjerimin e gjithëpërfshirjes qytetare.

Në përfundim do të doja të nënvizoja se të gjithë kanë të drejtë për qytet dhe se kjo është një e drejtë elementare njerëzore. Sipas urbanistit marksist David Harvey, e drejta për qytet është (...) më parë një e drejtë kolektive se një e drejtë individuale, meqë ndryshimi i qytetit në mënyrë të pashmangshme varet nga ushtrimi i një fuqie kolektive gjatë proceseve të urbanizimit. Liria për të bërë dhe ribërë veten dhe qytetet tona është një nga të drejtat e njeriut më të çmuara, por edhe më të neglizhuara¹².

¹¹ Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development (p. 237). Taylor and Francis. Kindle Edition. (2010) marrë nga Basha, R., Planifikimi Urban për Qytetarët 4, EC Ma Ndryshe, dhjetori 2015

¹² Harvey, D., The Right to the City, <http://davidharvey.org/media/righttothecity.pdf>

EC MA NDRYSHË

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë me vizionin e krijimit të qytetit funksional që qeveriset nga të gjithë. Ndërsa vlerat të cilat e udhëheqin punën e organizatës janë: paanshmëria, aktivizmi, orientimi drejt rezultateve dhe komuniteti bazë e veprimit. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Prizreni, qytet pa bariera; Indeksi i Reformës dhe Transparencës Komunale; EC për Qytete Transparente dhe Gjithëpërfshirëse; Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren; Planifikimi dhe Zhvillimi Urban; Aktivizmi Kulturor dhe Urban në Prizren (2014); Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë; Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2015); Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjiilan (2013 – 2014); Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015); Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014); Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013); Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013); Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014); Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013; Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013); Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010); Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009); Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009); Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009); Forumet e Hapura Qytetare (2007); Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008); Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (2015); Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015); Katalogu - Bukur dhe Gjellbër (2015); (Pa) drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015); Plani Rajonal i Trashëgimisë për Rajonin Jug (2015); Urbanizmi si lexim i qytetit (2014); Qendra Historike e Prizrenit, Zonë e (Pa) Mbrojtur (2014); Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014); Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014); Paraja publike si "paret e babës" (2014); Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim (2014); Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014); Planifikim Urban për qytetarët (2014); Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013); Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013); Planifikimi Urban për Qytetarët (2013); Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013); Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013); Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013); Pesë analiza të projektit “Online Trasparency”; Një vit monitorim për më shumë transparencë; Degradimi Natyror dhe Urbanistik; Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale; Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje; Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013); Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012); Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011); Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009); Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009); Intervenimi me kosto të ultë (2009); Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008); Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008); Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).